



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 8 KORRIK 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
8. JULA 2011. GODINE**

**KORRIK – JULI
2011**

E premte, më 8.07. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetit Sasha Rashiq, i zgjedhur zëvendësministër për Punë të Brendshme, me deputetin e ri Milivoje Stojanoviq, kandidat i subjektit politik të SLS-së. Deputetit Stojanoviq i dëshiroj punë të mbarë dhe e ftoj që të nënshkruaj deklaratën e betimit.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjatë 5 minuta, ndërsa në emër të deputetit 3 minuta. Kërkoj që deputetët e paraqitur për diskutim që të deklarohen se në çfarë cilësie kërkojnë fjalën. Në emër të grupit parlamentar, fjalën e ka kërkuar deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës shpreh shqetësimin dhe indignatën e thellë lidhur me kërcënimin e drejtpërdrejtë që para dy ditëve i ka bërë Kryeministrit të Republikës së Kosovës deputeti i Partisë Lëvizja “Vetëvendosja”, zoti Florin Krasniqi. Ky njeri i cili ka arritur që të bëhet deputet në mënyrën se si është bërë, që konsiderohet si institucion, gardian i lirisë dhe i demokracisë sonë, ditë më parë në mënyrë të turpshme, madje publikisht kërcënoi Kryeministrin e Republikës së Kosovës se mund t’ia thyej dhëmbët atij personalisht, por nuk do ta bëjë një gjë të tillë sepse, sipas tij, kjo nuk është drejtësi. Shtrohet pyetja, çfarë ndodhë me një shoqëri, me një shtet kur njerëzit e tillë, në cilësinë e deputetëve gjykojnë se çfarë është drejtësi e çfarë nuk është. Ne, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kërcënimin e zotit Krasniqi dhe do t’i thyej dhëmbët kryeministrit të Kosovës e konsiderojmë si formën më primitive të reagimit njerëzor, por edhe politik. Ky është një atak i drejtpërdrejtë dhe i pashembullt mbi bartësit e institucioneve të Republikës sonë.

Kërkojmë prej Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe kryetarit të kësaj partie, zotit Albin Kurti, që të deklarohet nëse kërcënimi i zotit Krasniqi ka qenë një akt individual i tij, apo nëse edhe ky reagim krejtësisht jociwilizues është pjesë e strategjisë të kësaj partie për të atakuar institucionet shtetërore dhe udhëheqësit e këtyre institucioneve.

Në të dyja rastet, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dëshirojmë t'i sigurojmë qytetarët dhe t'i rikujtojmë zotit Krasniqi dhe Lëvizjes “Vetëvendosja” se as grushtet, e as kërcënimet për thyerje të dhëmbëve nuk mund dhe nuk do ta zëvendësojnë fuqinë e votës së lirë të qindra mijëra qytetarëve mbi bazën e të cilëve është formuar kjo Qeveri dhe është zgjedhur ky kryeministër.

Ne besojmë dhe për këtë jemi të bindur se asnjë grusht as brenda, as jashtë Kosovës nuk mund të jetë aq i fortë sa ta shkatërrojë dhe thyej punën e madhe që është bërë në këto 11 vite në demokraci për ta ndërtuar shtetin e Kosovës. Ne besojmë që nuk ka asnjë grusht aq të fortë që do të mund ta thyente vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe përcaktimin e tyre për të ndërtuar një shtet, ku drejtësia ndahet me ligj dhe jo me grushte. Prandaj, kërcënimet e tilla janë në kundërshtim flagrantë me mënyrën evropiane dhe perëndimore të të bërit politikë. Para së gjithash, janë në kundërshtim të pa riparueshëm me vlerat, kulturat dhe traditën e qytetarëve të Kosovës. Kanë qenë pikërisht qytetarët e Kosovës që me votën e tyre vazhdimisht i kanë grushtuar të gjithë ata që me primitivizëm kanë provuar të sjellin në institucione.

Ua rikujtoj kolegëve të “Vetëvendosjes” se shteti i Kosovës dhe institucionet e saja kanë para vetes probleme dhe sfida të shumta ekonomike apo politike, me to po përballemi sot dhe do të përballemi edhe një kohë. Mirëpo, që moti e kemi hequr një problem, përcaktimin tonë se pushteti fitohet vetëm dhe vetëm me votën e lirë, e assesi prej rrugës dhe assesi prej kërcënimeve.

Në kontinentin evropian ka perënduar ajo epokë. Dorën në zemër, të gjithë atyre që pushtetin e kanë marrë përmes rrugës apo përmes revolucioneve, në të gjithë botën po u ngushtohet rrethi. Prandaj, të gjithë ata që kanë këso ide të marra, le të jenë të bindur se ato edhe do të mbesin vetëm si ide të marra dhe në mënyrë të vazhdueshme do të ndëshkohen nga vullneti politik i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit parlamentar, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra, deputetë,

Sot po bëhen 47 ditë nga vendosja e një pjese të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në tendat e ngritura para institucioneve më të larta të Republikës së Kosovës, Presidencës, Parlamentit dhe Qeverisë së Kosovës.

Këta veteranë fillimisht në mënyrën më të qetë dhe civilizuese i publikuan kërkesat dhe nevojat e tyre që çështja e veteranëve të trajtohet me ligj dhe në mënyrë institucionale. Por, fatkeqësisht, askush nga autoritetet relevante nuk e trajtoi këtë shqetësim.

Veteranët, ashtu siç kishin premtuar, kaluan në grevë urie të vendosur fuqishëm në kërkesat e tyre. Përkundër bindjeve se bëhet fjalë për një grup të vogël të nxitur politikisht dhe të manipuluar nga ndonjë parti politike, ky grup i veteranëve të “padëgjueshëm” dhe kinse të “manipuluar” numerikisht u shumëfishua dhe aty ku fillimisht ishte ngritur një tendë e vogël, tani është shndërruar në mini lagje prej tendave.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë i kemi të freskëta kujtimet nga paraqitjet tona publike në fushata, në media e tjera. Me premtime se veteranët janë një ndër kategoritë e para që do të përfitojnë, nëse dinë si ta adresojnë votën. Por, ja që tani, edhe pas 12 viteve në liri, veteranët janë një ndër kategoritë më të përbuzura të shoqërisë sepse nuk iu qëndruan besnik premtimeve dhe së paku as nuk vërehet disponimi i institucioneve të Kosovës për tejkalimin e kësaj situatë.

Veteranët nuk kërkojnë benificione dhe tretmanë të parealizueshëm, përveç të rregullimit të statusit të tyre me ligj, njëjtë apo analog me praktika të vendeve që këtë çështje e kanë të rregulluar me ligj, ashtu që edhe kjo kategori të jetë e dobishme për familjet, shoqërinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Ne duhet t'i kemi parasysh se në mesin e tyre janë shumë invalidë të luftës, me dëmtime të rënda trupore, me shëndet të rrënuar, pa gjymtyrë dhe po ashtu edhe të verbër. Së paku nga aspekti human dhe etik, këtë çështje duhet ta trajtojmë me një kujdes dhe prioritet të veçantë.

Derisa ne bëjmë plane se si do t'i kalojmë pushimet në vende ekzotike dhe të freskëta, larg problemeve dhe streseve ditore, e kam frikën se veteranët që gjenden në grevë urie, do të përballen me vapën dhe nxehtësinë me kushtet mizore të akomodimit, higjienës e të tjera, duke kërkuar pak freski nën hijen e disa shkurreve aty pranë dhe nën hijen e përmendores së Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Krejt në fund, kërkoj që Qeveria e Kosovës me urgjencën më të madhe të procedojë Ligjin për veteranët tek Parlamenti i Kosovës, për shqyrtim dhe miratim, dhe veteranëve të grevë t'ju ofrojë të gjitha garancitë për procedimin e ligjit me qëllim që greva të ndërpritet dhe të njëjtit t'iu kthehen familjeve, punës, nëse e kanë, dhe jetës së përditshme. Faleminderit!

KRYETARI: Ne po vazhdojmë me pikën e rendit të ditës edhe pse, po them, deputetët nuk janë duke lexuar nenin 47 se çka mund të ngritet në këtë pikë të rendit të ditës. Megjithatë, përgjegjësinë e marrin ata që flasin.

Në emër të Grupit të Aleancës, kush e ka kërkuar fjalën? Deputeti Burim Ramadani, veç është mirë të lajmërohen paraprakisht ata që donë të flasin në emër të grupit parlamentar, le të lajmërohen edhe bile le ta thonë edhe temën për të cilën do të flasin!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dua të shprehë shqetësimin tonë të thellë për keqpërdorimin e qëllimshëm nga njerëz të caktuar të ndjenjave dhe kërkesave fetare në Kosovë, që po ndodhë gjatë periudhës së fundit.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është e bindur se protestat e organizuara në fund të qershorit dhe sidomos qëllimet e njerëzve prapa atyre protestave janë të papranueshme për Kosovën.

Kosova shumë kohë më parë ka zgjedhur rrugën e vet, ka zgjedhur orientimin e vet. Ky orientim është drejt NATO-së, ky orientim është drejt Bashkimit Evropian dhe ky orientim është drejt vlerave perëndimore dhe ky orientim nuk mund të luhetet nga njerëz të tillë, nga qëllime të tilla. NATO, pjesë të së cilës ne synojmë të jemi, ka qenë vendimtare në çlirimin e Kosovës dhe shpëtimin e popullatës këtu. NATO përbëhet mu prej vendeve të cilat edhe më tutje po vazhdojnë të ndihmojnë të tashëm dhe të ardhmen tonë. Po e përsëris, Kosova dhe shqiptarët janë të paluajtshëm në orientimin dhe besimin e fuqishëm në vlerat perëndimore, ku pikësynim kryesor është rruajtja dhe promovimi i lirës, i barazisë dhe i drejtave të njeriut. Këto vlera kanë qenë dhe këto vlera janë udhërrëfyesi ynë për të ndërtuar një shtet funksional, një shtet ligjor, me demokraci të konsoliduar dhe të integruar ndërkombëtarisht. Këto vlera dhe këto synime janë ato që e bëjnë jetën e qytetarëve të Kosovës më të mirë, e jo diçka tjetër. Ne nuk duhet të lejojmë dhe ne nuk do të lejojmë që dikush, për hir të pseudo interesave dhe duke përdorur gjuhë të urrejtjes të na dëmtojë të gjithë neve, ta dëmtojë shtetin e Kosovës dhe ta dëmtojë jetën më të lumtur të qytetarëve të Kosovës.

Kërkesa e besimtarëve islam për një xhami nuk guxon të kthehet, të shndërrohet në një manifestim me flamur të zi në qendër të Prishtinës. Pamja e flamur të zi nuk është pamja e Kosovës, nuk është pamja e popullit të Kosovës. Ne duhet të tregojmë se ajo pamje nuk është fytyra e Kosovës dhe nëse dështojmë që të tregojmë se ajo pamje nuk është fytyra e Kosovës, ne kemi dështuar misionin tonë patriotik.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i fton të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të gjithë ata që me të drejtë kërkojnë xhami, që të distancohen nga ata që tentojnë të keqpërdorin ndjenjat fetare të njerëzve në Kosovë për qëllime të tyre destruktive dhe të mos lejojnë që të jenë pjesë e këtyre keqpërdorimeve.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fton popullin e Kosovës, të gjitha forcat politike dhe posaçërisht Qeverinë e Kosovës, që edhe më tutje të afirmojnë vlerat tona që kemi shpalosur gjatë gjithë historisë tonë, bazuar në tolerancë ndërfetare dhe synimet tona për të ndërtuar demokraci të mirëfilltë perëndimore. Ne ftojmë të gjithë që edhe një herë të afirmojmë energjitë tona që kemi pasur gjatë viteve '90 e deri më tash për të ardhmen tonë perëndimore dhe demokratike në Mijëvjeçarin e ri. Ne ua bëjmë të qartë fuqishëm miqve tanë ndërkombëtarë, se shqiptarët e Kosovës kurrë nuk kanë qenë pjesë e fundamentalistëve dhe kurrë nuk do të jenë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për shfrytëzimin e korrektësi të pikës së rendit të ditës!
Fjalën e ka në emër të Grupit të “Vetëvendosjes” deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Marrëveshjet e arritura gjatë negociatave mes Qeverisë sonë dhe Serbisë e kanë mohuar shtetësinë e Kosovës në shumë pikat e marrëveshjes, siç është ta zëmë, çështja e targave. Kosova kthehet para shpalljes së pavarësisë së 17 shkurtit, pra ajo kthehet në kohën e UNMIK-ut. Këto marrëveshje që tash po quhen konkluzë, e vërtetojnë tezën e kamotshme të “Vetëvendosjes” së pavarësisë pa sovranitet dalëngadalë fillon të rrjedhë edhe formaliteti. Në vend që Kosova prej 17 shkurtit 2008 e këndej të shkonte kah kompletimi i sovranitetit, ajo po shkon kah mpakja e pavarësisë. Këto marrëveshje janë krejt të njëanshme.

Serbia vazhdon të mos e njohë Kosovën, kurse Kosova nëpërmjet Qeverisë jo vetëm që po e njeh Serbinë si shtet, por po e njeh atë edhe brenda Kosovës.

Grupi negociator i Kosovës ka dhënë garanci se Serbisë nuk do t’i preken strukturat e saj të paligjshme në Kosovë. Hashim Thaçi tash e tutje mund të udhëtoj në Bruksel vetëm kur është në pyetje Beogradi. Afërsia e tij me Brukselin është e kushtëzuar me afërsinë e tij ndaj Beogradit. Vetëm një darkë e Hashim Thaçit na kushtoi tre marrëveshje të tilla me Serbinë. Në këto negociata delegacioni i Kosovës ka pasur për qëllim që të krijojë një imazh të paqenë dhe të gënjeshtërt të Serbisë, imazhi i një Serbie fqinjësore, miqësore, evropiane, demokratike, jo problematike. Kurse në të vërtetë Serbia ndaj Kosovës është armiqësore dhe agresive, e cila nuk na njeh dhe e cila na mbanë të ndarë, e cila nuk ka kërkuar falje për krimin, e cila nuk na ka zhdëmtuar për shkatërrimet, e cila luan me fatin e të pagjeturve dhe e cila i keqtrajton shqiptarët në Luginë. Kjo është Serbia e vërtetë, dhe jo Serbia e grymosur nëpërmjet negociatave me Qeverinë e Kosovës. Këto negociata mund të definohen fare thjeshtë: Kosova nuk po e merr atë që i takon, kurse Serbia po e merr atë që nuk i takon. Dhe këtu nuk është halli që Serbia po sillet kështu. Tek e fundit, ne si shqiptarë e njohim moti projektin serb për tokat shqiptare. Shqetësimi i vërtetë është ky se si disa politikanë shqiptarë po i përgjigjen me aq zell agjendës së Serbisë.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” këto marrëveshje nuk i konsideron të Kosovës, por të Hashim Thaçit dhe të Qeverisë së tij. Faleminderit!

KRYETARI: Unë po kërkoj edhe një herë, temat që mund të futen në rend të ditës, bëni kërkesë 6 deputetë, hynë në rend të ditës. Mos e keqpërdorni këtë pikë të rendit të ditës, nga shumica e deputetëve po keqpërdoret. Prandaj, është mirë që vërtetë ta lexoni dhe ta kuptoni mirë këtë pikë të rendit të ditës pse është, ose po e heqim krejt, nuk jemi në rend të ditës.

Koalicioni për Kosovë të Re, Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Para dy javësh, në emër të Grupit kemi folur në binën e Parlamentit të Kosovës, duke shprehur shqetësimin e qytetarëve të Prishtinës dhe me këtë rast ne dëshirojmë tani të përshëndesim vendimin e Komunës së Prishtinës që po bashkëpunon me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe me qytetarët e Prishtinës për të gjetur një hapësirë për ndërtimin e një Xhamie të madhe, në mënyrë që të plotësohen nevojat e qytetarëve të kryeqytetit.

Liria fetare duhet të promovohet në Kosovë, sikurse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga miku ynë, të cilët nuk e nënshkruan Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të gjitha shtetet, përderisa nuk u miratua edhe Karta e të drejtave Bill of Rights, ku i pari amendament i Bill of Rights ishte liria fetare. Në këtë rast dëshirojmë që të inkurajojmë të gjitha institucionet e Kosovës dhe komunat e Kosovës që të bashkëpunojnë me qytetarët e vet, të bashkëpunojnë me bashkësitë fetare në Kosovës dhe të promovojnë vlerat tona kombëtare dhe fetare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Arsyeja e marrjes së fjalës është të jap një informatë krejtësisht të shkurtër për rrjedhën e procesit të kushtetutës, që mendoj se është me interes për deputetët, por edhe për publikun e gjerë për të kuptuar rrjedhën e këtij procesi shumë të rëndësishëm.

Në fakt, Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës është në përmbyllje të fazës së parë dhe me një punëtor që do ta kemi nesër, ne jemi në përmbyllje të fazës së parë dhe kemi arritur të identifikojmë çështjet që do të jenë objekt i reformës kushtetuese brenda mandatit ligjor të përcaktuar nga Kuvendi i Kosovës. Tanimë ne po punojmë në dy drejtime për implementimin e këtij mandati.

Drejtimi i parë, përfshin ndryshimet në Kushtetutën e Kosovës që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit dhe këto do të përmbyllen me një pako të amendamenteve, që do të mundësojnë këtë reformë shumë të rëndësishme.

Drejtimi i dytë, është përgatitja e Projektligjit për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit dhe ne jemi duke punuar edhe në dy nëngrupe punuese, të cilat janë duke e përgatitur Projektligjin për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit.

Tanimë Komisioni ka identifikuar po thuaj se të gjitha çështjet që kanë qenë objekt i draftimit kushtetues dhe në fazën e dytë, e cila do të pasoj gjatë pushimeve verore dhe do të përfundojë deri në fund të shtatorit, ne do t'i kemi të gatshëm versionet e para të amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës dhe projektligjin. Gjatë kësaj faze ne do të kemi një proces të gjerë të konsultimeve politike, të konsultimeve me opinion e gjerë, me shoqërinë civile, konsultime me të gjitha partitë politike parlamentare dhe jashtë parlamentare, me të gjitha subjektet relevante për ta bërë procesin sa më transparent.

Siç dihet, procesi do të përfundojë në muajin janar, atëherë edhe kur e kemi përfundimin e mandatit 9 mujorë, dhe brenda afatit të parapërcaktuar Komisioni do t'ia dorëzojë Kuvendit të Kosovës pakon e amendamenteve kushtetuese dhe Projektligjin për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit.

Ajo çfarë ne kërkojmë, kërkojmë që të gjitha partitë politike parlamentare të jenë pjesë e këtij procesi, të shqyrtojnë me kohë përmes përfaqësuesve të vetë dhe përmes ekspertëve që kanë caktuar në Komision të shqyrtojnë zgjidhjet politike sepse, siç dihet, shumë pozicione kërkojnë edhe një konsensus të gjerë politik dhe gjatë gjithë procesit ne të mundohemi t'i mbajmë partitë politike të njoftuar dhe të familjarizuara me këtë proces dhe të gjithë të shprehin qëndrimet e veta në mënyrë që propozimet kur të vijnë në Kuvend, të marrin edhe pëlqimin e të gjitha partive politike, duke qenë se procesi i ndryshimit kushtetues nuk është një proces thjeshtë politik, por më tepër është një proces shtetëror, i cili kërkon ndërtimin e një konsensusi në mënyrë që vendit tonë t'i krijojmë një stabilitet të nevojshëm kushtetues. Faleminderit!

Drejtimin e seancën e merr nënkryetari i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e merr deputetja Vesna Mikiq.

VESNA MIKIĆ: Hvala!

Poštovani predsjedavajući,

Uvaženi poslanici,

Ja dolazim iz opštine Ranilug, koja se od prošle godine do danas susreće se sa mnogobrojnim problemima. Jedan od tih problema je vezan sa budžet, a drugi za razmenu zemljišta.

Naime, kada je budžet u pitanju, mislim da je apsurdno upoređivati opštinu od tri sela koja se mogu uzduž i popreko prepešačiti, sa opštinama koje u svom sastavu imaju 15 sela. Ja ću zbog kratkog vremenskog roka izlaganja staviti akcenat samo na operativne kodove. Znači, prvo ću krenuti sa Kodom za komunalije.

U tom kodu imamo samo 5.000 evra, što je bez malo smešno ako uzimamo u obzir da se opština Ranilug, ako opština Ranilug funkcioniše u dve odvojene zgrade, u dva različite sela, u čijem sastavu ima 4 škole, jednu predškolsku ustanovu, sa 5 isturenih odeljenja, 7 ambulanti i jedan dom zdravlja. Ovaj novac će biti dovoljan samo za podmirivanje telefonskih računa i električne energije. Znači, u principu da izdržimo dva meseca.

Što se tiče koda - Roba i usluge, u tom kodu imamo nekih 50 hiljada, koje će biti dovoljne za derivate i plaćanje Agencije za obezbeđenje, a da ne pričam sad o kapitalnim investicijama, koje su kod nas misaona imenica. A svakoga dana nam stižu poruke iz Prištine, odnosno iz centrale, iz Vlade da moramo otvoriti Centar za socijalni rad, Odeljenje privrede, šumarstva i ruralnog razvoja. Pitam se samo od kojeg ćemo para plaćati te radnike i kakav će biti kvalitet rada tog odeljenja.

Ispada da je ono što su nam pričali na početku da ćemo imati potpunu autonomiju u kreiranju budžeta, čista laž. Naime, ne da nema autonomije, već su nas vratili u prvobitni okvir.

Što se tiče drugog problema vezano sa razmenu zemljišta, opština Ranilug već godinu dana pokušava da napravi pomak i da nađe rešenje za taj problem, međutim od upućenih tri zahteva, od kojih je poslednji uručen 15 marta, još uvek nismo dobili nijedan odgovor. Opština je svojim zalaganjem, svojim radom uspela da privuče kako domaće, tako i strane investitore, međutim zbog ovog problema mi i dalje stojimo u mestu. Radi se o investiciji od 30 miliona evra, koji bi bili uloženi u dva objekta, gde bi opština Ranilug u samom startu mogla da zaposli 700 radnika. Jedan objekat bi bio Banjsko rekreativni centar, koji bi bio najveći na Balkanu, i drugi - otvaranje Pogona za proizvodnju zimnice.

Međutim, mi još uvek rešenja nemamo i plašim se da će ovo ostati tako zbog nečije neažurnosti, pa mi se prosto nameće pitanje kome ide u prilog zapravo opstruiranje rada novih opština, da li je to strah od uspeha ili je zapravo tendencija da se prikaže u očima međunarodne zajednice da nove opštine nisu funkcionalne i da ne mogu opstati kao samostalne, kako bi se vratile u roku tri godine pod okriljem matičnih opština. Ispada da smo vreme lagali sebe i svoj građane da će proces decentralizacije doneti poboljšanje kvaliteta života. Ovde ne samo da nema decentralizacije, već je po svim naznakama čist centralizam. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Hvala, poštovani predsedavajući!

Gospodo ministri, uvažene kolege, zastupnici u Parlamentu Republike Kosova, Kao zastupnik u ovom parlamentu, a inače poreklom iz Dragaške opštine, imam moralnu obavezu da deklarišem jedan krupan problem van dnevnog reda ovog sjednice.

Naime, poslednjih nekoliko meseci učestale krađe u pograničnom djelu Dragaške opštine prema susednom Albanijom i Makedonijom, prije svega mislim na atar sela Restelice, zabrinjavaju mještane u ovom kraju. Mještani sela Restelice su uplašeni i izrevoltirani zbog ove veoma česte i učestvovala pojave.

Najčešće se krađe krupa stoka. Prema podacima sa terena, samo od početka ove godine je ukradeno više od stotina grla krava i konja. Meta lopova su i prazne kuće naših gastarbajtera, najčešće se krađe tehnika, a ako se lopovi osiguraju da domaćina nema, i krupni predmeti.

U javnosti se vrlo malo govori o ovoj negativnoj pojavi, a i organi policije ne pokazuju željene rezultate u suzbijanju kako već sami mještani ističu, organizovanog kriminala. Naime, za dvije godine nije rasvetljen niti jedan slučaj krađe u ovim selima. S druge

strane, redukcija policijskog osoblja Dragaške policijske stanice, pa i regionalne, još više izazivaju revolt kod građana. Umesto da se se poveća broj policajaca, Regionalna policija smanjuje broj svojih zaposlenih, kao da nema nikakvih problema.

Prema mojim saznanjima, Policijska stanica u Kruševo ima uposleno samo 7 policajaca, dok je, ako se ne varam, prema nekim pravilima na svakih 500 građana bi trebalo da bude angažiran makar po jedan policajac, što bi trebalo da iznosi cirka 15 policajaca u jednoj smjeni.

Najveće selo, oko 7 hiljada stanovnika, Restelica, nema svoju policijsku stanicu, a pogranična policija umesto da obavlja svoje obaveze u predviđenom pojasu granice, izlazi na regionalnom putu Dragaš-Rstelica e kažnjava same mještane.

Iz gore pomenutih razloga, tražim da se što prije na terenu pošalju članovi Komisije za bezbednost kako, bi na osnovu razgovora sa mještanima i sa policijom prikupili sve potrebne podatke za suzbijanje ove pojave i doneli konkretne predloge za rešavanje ovog velikog problema. Molim resornog ministra koji veoma dobro poznaje naše krajeve, da se lično založi u rešavanju ovog problema, koji može da eskalira i u proteste izrevoltiranih građana, jer su spremni i spremili su i peticiju i zahteve i predali kompetentnim organima.

Umesto da razmišljamo o turističko-ekonomskim ulaganjima u ovim prelepim Šarskim pejzažima, a inače najnerazvijenijoj opštini i gde su stanovnici željni integracije, ali primorano ekonomski da traži nafaku van Kosova, mi danas govorimo o krađama koje su rak rana za mještane sela Restelice, Kruševo i Zlipotok...

KRYESUESI: Të kaloi koha, zoti deputet, faleminderit!
Fjalën e merr deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje, ministra, zëvendëskryeministra!
Çështjet të cilat u ngritën këtu, janë disa për kritika, por megjithatë dinjiteti i deputetit e tregon çfarë duhet të ngritë në këtë çështje dhe mos të marrë kohën e deputetëve për të tjera.

Unë mendoj që për marrëveshjen që u diskutua, është i nevojshëm një debat të bëhet në Kuvend të Kosovës.

KRYESUESI: Zoti deputet, s'ka replikë, thuaj temën tënde, i ke 3 minuta.

NAIT HASANI: Po, për temën time po flas.

KRYESUESI: Jo, jo, thuaj çka ke, 3 minuta i ke!

NAIT HASANI: Unë kërkoj që çështjen e marrëveshjes ta debatojnë në Kuvend të Kosovës dhe mos të shkojë për 3 minuta, ashtu qysh e tha edhe kryetari dhe unë nuk jam i interesuar të merrem me këtë çështje më shumë.

Unë do të kërkoj që ministri i Mjedisit, tani veç nuk është, është ministri i Ekonomisë, ne kemi miratuar me një vendim të Qeverisë që të lejohen makinat e vjetra mbi 8 vjet. Edhe ashtu kemi varreza masive të makinave dhe ndotje masive të ambientit, kështu që kërkojmë ky vendim të abrogohet pikërisht sepse Kosova është mjaftë e ndotur dhe mos ta ndotim edhe më shumë me këto makina.

Çështja tjetër që është me rëndësi, është që edhe këtu nuk e kemi ministrin e Arsimit, por duhet ta dimë se Universiteti i Prizrenit a është i licencuar dhe ky Kuvend a ka miratuar një vendim të tillë për Universitetin e Prizrenit, sepse Universiteti i Prizrenit hala është vetëm me një vendim të qeverisë.

Edhe një tjetër, që ministrin e Jashtëm nuk e kemi këtu, po ashtu, është që deklaratat e tij nëpër shtyp që del e thotë që tanimë i kemi zgjidhur çështjet dhe çështjet e fundit është Kosova e zgjidhur si çështje në Ballkan, si shtet dhe në ish Jugosllavi. Unë mendoj që kjo është një teori komuniste, ndërsa një mendim demokratik, po mendoj se duhet ta kemi të qartë që çështja e përfundimit të shteteve nuk përfundon kurrënjëherë, sepse shtetet lindin dhe krijohen edhe në këtë aspekt, nëse ministri ka menduar ashtu, se çështja e përfundimit të shteteve, atëherë kemi edhe ish mendimin komunist, që ai kur ka ardhur në pushtet, secili sistem komunist ka thënë që ne e kemi zgjidhur çështjet etnike dhe çështjet e shteteve. Prandaj, mendoj që edhe këtu do të kemi qasje më të drejtë edhe në politikën e jashtme, sepse ndërrimet e pushteteve nuk do të thonë që është zgjidhur çështja shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Koha prej një gjysmë ore u harrxhua. Ju njoftoj që kanë mbetur të paraqitur për herën tjetër deputetja Donika Kadaç - Bujupi, deputetja Flora Brovina, deputeti Liburn Aliu dhe deputeti Zenun Pajaziti.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Unë besoj që tash procedurën e dini. Ju njoftoj që kemi kohë të akorduar për 60 minuta me Rregulloren, kemi 9 pyetje parlamentare: Visar Ymeri, Aurora Bakalli, Alma Lama, Lirije Kajtazi, Bekim Haxhiu, Enis Kervan, Agim Kuleta, Ganimete Musliu. Thërras deputetin Visar Ymeri, që ka pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zoti deputet, kryeministri nuk është këtu, unë të lus a do ta lexosh pyetjen apo do të presësh që të marrësh përgjigje prej kryeministrit, është e drejta e juaj. Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Me qenë se pyetja ime ka të bëjë me privatizimin e Postës, edhe pse nuk është kryeministri këtu, kësaj pyetje mund t'i përgjigjet ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, po qe sa ai është i gatshëm. Nëse ai është i gatshëm, unë do ta lexoja pyetjen.

Qeveria e Kosovës përkundër kundërshtimeve të mëdha që kanë ndodhur ndaj këtij procesi, megjithatë ka proceduar në planin për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Në buxhetin e vitit 2011, është paraparë që privatizimi i PTK-së të sjellë rreth 300 milionë euro. Pra, kompania më fitimprurëse, sipas Qeverisë, nuk vlen më shumë se 300 milionë euro. Gjithmonë na është thënë se vlerësimi është bërë duke marrë për bazë vlerën e aseteve fizike dhe profitin e parashikuar për vitet e ardhshme, duke u bazuar në historinë e profitit të PTK-së.

Gjatë muajit të kaluar është ngritur aktakuzë nga prokuroria për drejtorin e përgjithshëm të PTK-së, Shyqri Haxhën, si dhe kryetarin e Bordit, Rexhë Gjon Balaj, i emëruar nga Qeveria Thaçi 1, për lidhje të kontratave në dëm të PTK-së, që në mënyrë të konsiderueshme kanë dëmtuar profitin e PTK-së.

Pyetja ime është kështu: Përderisa do të vazhdojë procesi gjyqësor kundër personave të përmendur më lartë dhe duke ditur që veprimet e tyre kanë zhvlerësuar PTK-në dhe çmimin, a do të procedojë Qeveria me privatizimin e PTK-së? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Procesi i privatizimit të Postës dhe Telekomunikacionit është proces transparent, i hapur, proces i cili ka marrë aprovimin e këtij Kuvendi, do të thotë me ligjin dhe konform këtij vendimi të Kuvendit ne kemi proceduar me një procedurë konkurruese në kuadër të normave ndërkombëtare. Procesi është në vijim e sipër dhe normalisht, nëse të gjitha kushtet do të plotësohen konform standardeve më të larta, do të vazhdojë procesi i privatizimit. Lidhur me aktakuzën, pushtetet janë të ndara, gjyqësia dhe drejtësia ka një çështje tjetër, ndërsa menaxhimi dhe vazhdimi i procedurave të rregullta administrative për transformimin e pronës do të vazhdojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër Beqaj!

Zoti deputet Ymeri!

VISAR YMERI: Ju faleminderit!

Pyetja ime kishte të bënte me faktin që këto akuza për të cilat janë ngritur kundër Shyqri Haxhës dhe kryetarit të Bordit Rexhë Gjon Balaj kanë të bëjnë me kontratën, e cila është dëshmuar qartë se e ka dëmtuar PTK-në. Pra, ju disa herë keni thënë që një prej arsyeve që po e shitni PTK-në, përveç tjerash, është keqmenaxhimi i saj dhe, në anën tjetër, është rënia në vlerë e PTK-së për shkak të humbjes së primatit në treg që ka pasur para së hyrjes së IPKO-s. Ndërkohë, këto hetime që po kryhen kundër kësaj kontrate po e dëshmojnë një gjë tjetër, që keqmenaxhimi aty ka qenë i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm,

pra me intervenimin e Qeverisë dhe, në anën tjetër, që ky dëmtim apo zhvlerësim i PTK-së është bërë në mënyrë të vetëdijshme nga persona të caktuar. Me qenë se është duke ndodhur ky hetim dhe me qenë se tash dihet botërisht që PTK-ja është zhvlerësuar, a mendoni se është e mençur që të vazhdohet pra me privatizimin e PTK-së, kur dihet që blerësit potencial do ta përdorin edhe këtë, a duhet për t'ia ulur vlerën kësaj kompanie?

KRYESUESI: Ministri Beqaj!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe një herë, deputet Ymeri, do të thotë është një proces i cili është i rregulluar me rregulla dhe norma standarde vendore dhe ndërkombëtare. Ju e përmendët edhe në pjesën e parë të pyetjes tuaj, të konstatimit tuaj se është bërë edhe vlerësim, unë nuk di ku e keni marr atë informacion, është thënë disa herë nga ana e juaj dhe nga shumë të tjerë që vlera e postës është vleruar në 300 milionë euro. Asnjëherë, në asnjë moment nuk ka pasur vlerësim të asaj dhe vlerën e transaksionit do ta caktojë tregu në bazë të një konkurentshmërie dhe ky është proces për të cilin neve si ministri dhe si Qeveri jemi të përkushtuar dhe do të zbatojmë format më të larta të standardeve ndërkombëtare. Edhe një herë po e them, sa iu përket çështjeve të aktakuzave dhe çështjeve të kontratave të cilat janë bërë, përgjegjësia është individuale. Normalisht, unë asnjëherë në asnjë rrethanë nuk kam deklaruar që menaxhmenti i Postës dhe Telekomit ka bërë veprime të dëmshme sepse nuk është e imja që ta vlerësoj atë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndërsa, sa u përket kontratave në fjalë, fjalën e ka drejtësia. Drejtësia duhet të vendos dhe deri atëherë ne do të vazhdojmë, nëse drejtësia vendos që ato janë të dëmshme, përgjegjësia është individuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Ganimete Musliu, ka pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Ministri s'është këtu, deputete a do ta shtrosh pyetjen? Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Me qenë se ministri Hoxhaj nuk është prezent, pyetjen do ta kaloj për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Agim Kuleta, ka pyetje për ministrin Dardan Gashi.

Fjalën e ka deputeti Kuleta, ministrin s'po e shoh, a do ta shtrosh pyetjen? Regjia, Agim Kuletës, fjalën!

AGIM KULETA: Ministri është në ambientin në Kuvendit, po shpresoj që kthehet për pak. E bëjë pyetjen, pastaj.

KRYESUESI: Shpreson, por kthehesh edhe ti, edhe ai.

Shkojmë tutje. Deputeti Enis Kervan, ka pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Nuk do ta shtrojë pyetjen deputeti Kervan.

Deputeti Bekim Haxhiu, ka pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Çështje ka të bëjë me konkursin e fundit në Qendrën Klinike Universitare dhe në kohë të gjatë ushtrimin e detyrës së drejtorit, domethënë, nga ana e ushtruesit.

I nderuar ministër, përse në dy konkurset e futet për drejtor të QKUK-së është shkelur statusi i Qendrës Klinike Universitare me rastin e publikimit të konkursit, anulimit dhe ripublikimit të tij? Statuti i QKUK-së parasheh që të ketë së paku 5 vite përvojë pune menaxheriale për të pasur të drejtë konkurrimi për drejtor të QKUK-së, ndërsa Ministria e juaj në konkursin e parë ka paraparë të drejtën për konkurrim për drejtor të ketë 7 vite përvojë pune, ndërsa në konkursin e tanishëm së paku 3 vite përvojë pune, në të dy rastet në kundërshtim me Statutin e Qendrës Klinike Universitare. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Agani!

FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuari deputet Haxhiu,

Çështja të cilën e keni ngritur ka të bëjë me pjesën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ju e dini se ingjencat e ministrit në atë aspekt janë të kufizuara. Do ta lexoj informatën zyrtare nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë përkitazi me këtë çështje.

“Ministria e Shëndetësisë ka bërë shpalljen publike të rekrutimit për pozitën e drejtorit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në harmoni të plotë me legjislacionin aktual në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës së shërbyesve civilë. Në vështrim të nenit 10, paragrafi 10.1 dhe 10.2 të Rregullores nr. 03/2010 për shërbimin civil, për përshkrimin e detyrave të punës, e aprovuar me datë 20.09.2010, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në cilësinë të zyrtarit më të lartë administrativ brenda institucionit të punëdhënësit, ka miratuar ndryshimin dhe plotësimin e përshkrimit ekzistues për pozitën e drejtorit ekzekutiv në QKUK, duke pasur parasysh faktin se praktika e gjertanishme ka treguar se kjo pozitë e punës ka nevojë për kuadro me përvojë në pozita menaxheriale, si kushti i domosdoshëm për arritjen e përmbushjes së detyrave të punës dhe objektivave të përgjithshme të QKUK-së. Pavarësisht statutit të QKUK-së, të nxjerrë në vitin 2007, që edhe ashtu është në fazën e rihartimit, i cili i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Rregullorja për përshkrimin e detyrave të punës ka fuqi juridike më të madhe se sa statuti dhe në këtë aspekt zbatimi i nenit 10 të kësaj ka afuar mundësinë ligjore që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i përshkrimit të punës, jo vetëm për këtë pozitë, por për cilido pozitë të punës kur është e nevojshme për një gjë të tillë.” Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti deputet, a ke pyetje të dytë? Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Qëllimi edhe i pyetjes sime ishte të vij në konkluzione që statuti i Qendrës Klinike Universitare nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi. Prandaj,

është edhe detyrë e sekretarit permanent dhe e zyrës juridike të Ministrisë që të punojë në këtë drejtim që të jetë ajo në harmoni dhe të kemi një statut të vërtetë të Qendrës Klinike Universitare që ajo t'i plotësojë qendrat, tamam të jetë Qendër Klinike Universitare për shkak se për momentin ajo nuk i plotëson nevojat as të një spitali regjional të Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: ... nuk e do fjalën. Edhe një herë deputeti Bekim Haxhiu, prapë pyetje për ministrin Agani. E ka fjalëzën Bekim Baxhiu.

BEKIM HAXHIU: Çështja e dytë që do ta ngrejë, domethënë është çështja e ikjes së kuadrove të personelit shëndetësorë nga Qendra Klinike Universitare.

I nderuar ministër, Si mendoni t'i joshni mjekët dhe personalin shëndetësorë që të mos braktisin Qendrën Klinike Universitare, derisa atyre ju ofrohen paga të majme nga klinikat private, ngase numri i personelit shëndetësorë që po braktisin Qendrën Klinike dhe po kalojnë në klinikat private dita - ditës po rritet.

KRYESUESI: Ministri Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kjo dukuri shqetësuese në periudhën e fundit kohore është duke u redukuar dhe duke u zvogëluar në përmasa të saj. Masat konkrete që Qeveria i ka ndërmarrë sa i përket përmirësimit të pagave të punëtorëve shëndetësorë, nga njëra anë, dhe nënshkrimi i kontratës sektoriale me Federatën e sindikatave të shëndetësisë që ka rregulluar çështjen e pagesës së kujdestarive dhe punës shtesë, ka ndikuar dukshëm që motivacioni i punëtorëve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës të rritet dhe që të zvogëlohet dukshëm numri i atyre të cilët me vetë dëshirë largohen nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Një raport përkitazi me këtë çështje flet kështu: “Në vitin 2010, gjithsej 41 punëtorë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë larguar me vetë dëshirë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Prej tyre, 6 kanë qenë specialistë, 1 ka qenë farmacistë, 1 logoped dhe 33 infermierë, prej të cilëve 2 teknikë të anestezionit. Në vitin 2011, për 6 muajt e parë ky numër ka rënë në 13, që proporcionalisht flet për atë se kemi një trend të zvogëlimit të kësaj dukurie. Megjithatë, ne do të vazhdojmë që në mënyrë sistematike të përcjellim këtë çështje dhe duke i zbatuar reformat e pritura në shëndetësinë kosovare, konkretisht pas miratimit të Ligjit të shëndetësisë dhe të Ligjit për sigurime shëndetësore, që nënkuptojnë edhe riorganizimin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në përgjithësi të sistemit publik të shëndetësisë, të krijohet një ambient shumë më atraktiv dhe më i përshtatshëm për punë për të gjithë punëtorët shëndetësorë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, por edhe në spitalet rajonale dhe në kujdesin parësor shëndetësor në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti deputet Haxhiu, a ke pyetje shtesë? Deputeti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër, për sqarimin!

Përkundër që Qeveria e Kosovës ka bërë ngritjen e pagave, i nderuari ministër, a keni menduar që për ekspertë shëndetësorë të lëmive të caktuara në Qendrën Klinike Universitare të siguron pagesa shtesë nga Fondi për kuadër, në veçanti për Qendrën Klinike Universitare dhe si çështje strategjike për spitalin regional të Mitrovicës? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Agani!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar deputet,

Edhe ju jeni koshient për kufizimet e jashtëzakonshme buxhetore me të cilat ballafaqohet shëndetësia kosovare. Me siguri se nëpërmjet Fondit për kuadro do të shikojmë mundësinë që të stimulojmë kuadrot për të cilat kemi më së shumti nevojë, e konkretisht kriza më me madhe dhe nevojat më të mëdha janë në lëmin e anesteziologjisë dhe me siguri se në këtë drejtim do të punojmë, për momentin kufizimet buxhetore nuk e mundësojnë një gjë të tillë, por në rishikimin e buxhetit në fund të vitit duhet shikuar edhe këtë mundësi.

Sa i përket spitalit të Mitrovicës, çështja e shërbimit anesteziologjik është prej çështjeve më urgjente dhe kemi vështirësi të mëdha në sigurimin e kuadrit të nevojshëm.

Ministria e shëndetësisë me programin e specializimeve të cilën është kah e zbaton, ka bërë rekrutimin e 8 kandidatëve të ri për këtë drejtim, me një politikë afirmative për spitalin rajonal të Mitrovicës dhe jemi duke bërë përpjekje që të sigurojmë këtë kuadër edhe nga spitalet e tjera rajonale. Kështu që këto janë probleme ditore me të cilat jemi duke u ballafaquar nga dita në ditë. Situata nuk është duke u përkeqësuar. Niveli i shërbimeve për momentin është në atë minimumin, i cili e lejon funksionimin e spitalit, por në këtë drejtim kërkohet një angazhim edhe më i madh i tërë Qeverisë dhe unë do të bëjë këtë përpjekje që edhe me resorin e Ministrisë së Financave të gjejnë zgjidhje të cilat do të mundësojnë punësimin e numrit të shtuar të punëtorëve në spitalin rajonal të Mitrovicës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Aurora Bakalli, pyetje për ministrin Ferid Agani.

AURORA BAKALLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime i drejtohet ministrit Agani. Furnizimi i sektorit publik shëndetësor me barëra dhe material shpenzues vazhdon të jetë shumë u mangët. Nëse marrim si shembull Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, si qendër e cila ofron shërbime ose do të duhej të ofronte shërbime terciare në vend, në të aktualisht mungojnë rreth 40% të barërave nga lista esenciale dhe rreth 70% të materialit shpenzues, duke përfshirë këtu edhe gjërat elementare, siç janë gjilpërat, gaza sterile, leukoplasti e tjerë. Kjo situatë ka pasoja shumëdimensionale që i japin sektorit publik shëndetësor një imazh tejet të zbehtë. Ndër këto pasoja do të përmendi vetëm disa: Mjeku vendoset në një situatë shumë të pavolitshme, sepse nuk mund ta kryej detyrën e vet konform njohurive dhe standardeve mjekësore. Tek pacienti gjithmonë lind dyshimi, sepse duhet të dalë dhe të blej vazhdimisht barëra dhe material shpenzues jashtë spitalit. Dhe, në anën tjetër, afër

pacientit gjithmonë duhet të jetë një familjar, në mënyrë që të jetë në dispozicion në çdo çast që të shkojë dhe të blejë barëra të cilat janë të nevojshme, madje ndonjëherë edhe natën dhe kjo i jep spitalit një pamje të rrëmujës së përhershme.

Ndërkaq, pyetja ime për ju, zoti ministër, do të ishte: A mendoni ju se si ministër i Shëndetësisë mund të ndikoni që të sanohet kjo situatë shumë e rëndë dhe, nëse po, sa kohë vlerësoni se ju duhet që të arrini këtë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Agani e ka fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara deputete Aurora,

Ky është preokupimi ditor i imi çdo ditë gjatë tërë mandatit. Problem i jashtëzakonshëm, siç e përmendët, problem i cili reflekton mangësi të mëdha në shumë nivele. Fillimisht, me ndarjen e një buxheti tejet të ulët për blerjen e barërave dhe të materialit harxhues. Vetëm një shënim t'u japë. Buxheti për barëra në Kosovë është rreth 18.5 milionë euro, në Slloveni, e cila ka një numër përafërsisht të njëjtë të banorëve, rreth 1 miliard e 200 milionë euro. Ju mund të kuptoni se me këtë sasi të parave është shumë vështirë që të furnizohet tërë tregu dhe të gjitha nevojat shëndetësore të popullatës, sepse nevojat shëndetësore të popullatës së Kosovës dhe asaj të Sllovenisë janë të njëjta. Pavarësisht prej gjendjes ekonomike, sëmundja nuk pyet për regjion dhe për atë se sa janë të ardhurat bruto shoqërore. Prandaj, ky është një problem i cili duhet të zgjidhet në periudhën e ardhshme. Ne kemi projektuar masa të cilat do ta ndryshojnë këtë gjendje, filluar me vitin 2013. Konkretisht, Ligji i sigurimeve shëndetësore, që pritet të miratohet në tetor ose nëntor të këtij viti në Kuvendin e Kosovës, që pritet të hyjë në fuqi me mbledhjen e kontributeve prej 1 korrikut 2012 dhe fillimin e kontraktimit të shërbimeve në bazë të tij prej 1 janari 2013, do të sigurojë një buxhet shtesë për rreth 90 milionë euro, i cili dukshëm do të krijojë mundësi të re për përmirësimin e furnizimit me barëra.

Pra, në këtë drejtim ekzistojnë planet sistemore, por problemet ditore që i përmendët janë me të vërtetë të mëdha dhe jemi duke tentuar që t'i tejkalojmë. Në anën tjetër të problemit, pra kur e përmenda kompleksitetin e çështjes, nuk është çështje vetëm te ana financiare, por është çështja te mungesa e përgjegjësisë menaxheriale dhe mungesa e llogaridhënies. Unë po i jap vetëm disa shënime zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë për muajin qershor dhe korrik. Për muajin qershor dhe korrik Qendra Klinike Universitare e Kosovës është furnizuar me 38 artikuj citostatikë apo 74% të listës esenciale, në vlerë prej 350 mijë euro. Qendra Klinike Universitare është furnizuar me 133 artikuj barëra të ndryshme nga lista esenciale për muajin korrik apo 79% të listës esenciale me vlerë prej 200 mijë euro. Qendra Klinike Universitare është furnizuar me 166 artikuj të materialit shpenzues nga lista esenciale apo 69% të listës, me vlerë prej 79.500 euro. Shumë herë jemi në një situatë që barërat janë në barnatoret qendrore edhe të Qendrës Klinike Universitare, edhe të klinikave, ndërsa ato nuk janë te pacienti dhe afër pacientit, që flet për atë se kemi një mungesë, një zbrazëti, ku jemi duke punuar në identifikimin e këtij problemi. Instalimi i softuerit farmaceutik, i cili veç ka filluar të bëhet dhe do të përfundojë në gjysmën e muajit korrik, pra brenda javës, do të ngrejë dukshëm përgjegjësinë menaxheriale në të gjitha klinikat e Qendrës Klinike Universitare dhe në

tërë territorin e Kosovës, në të gjitha institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tërësor. Mendojmë se me këtë dinamikë do të përmirësojmë liferimin e barërave nga barnatoret qendrore të Qendrës Klinike Universitare deri në klinika dhe nga spitalet rajonale deri në reparte. Pra, në qoftë se duhet të përgjigjem shkurt përkitazi me atë se brenda çfarë kohe kisha pritur përmirësim, unë mendoj se një përmirësim të dukshëm duhet të presim nga fundi i vitit sa i përket mundësive aktuale, ndërsa sa i përket një përmirësimi substancial të situatës dhe përmirësimit të gjendjes me furnizim të barërave duhet pritur fillimin e vitit 2013. Faleminderit!

KRYESUESI: Regjia, mate kohën atje, se s'po e matë mirë!
Deputetja Aurora Bakalli, a ke pyetje shtesë?

AURORA BAKALLI: Zoti ministër, kur e kemi shqyrtuar buxhetin në fillim të vitit, shqetësimi im ka qenë që 18 milionë do të jetë definitivisht shumë e pamjaftueshme dhe e tillë parashihet të jetë edhe sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve, por ju na keni pas premtuar se ka edhe burime tjera, se shëndetësia më nuk bazohet vetëm në të ardhurat nga Qeveria, deri më tani një gjë e tillë nuk është parë.

Ndërkaq, këto shifra që i kam paraqitur unë këtu, domethënë 40% të barërave që mungojnë aktualisht dhe 70% të materialit shpenzues, nuk po flas vetëm për repartin ku unë punoj dhe ku e vërej që duhet të punojmë me dy antiaritmikë e jo me gjithë atë numër të madh, i cili duhet të jetë në dispozicionin tonë, por po flas me të dhënat që kam marrë prej Barnatores qendrore, domethënë prej listave nga Barnatorja qendrore kemi këto informata.

KRYESUESI: Këtu pyetje s'po shoh, po urdhëro!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është fakt se unë kam paralajmërua burime të tjera të financimit e jo vetëm ato buxhetore dhe konkretisht projekti i sigurimeve shëndetësore është njëri prej këtyre burimeve. Në anën tjetër, t'ju informoj edhe se ne do të fillojmë gjatë verës, gjatë këtij muaji të korrikut praktikisht të adaptojmë legjislacionin e nevojshëm, në gusht të fillojmë implementimin e çmimoreve të shërbimeve shëndetësore për institucionet shëndetësore me të cilat do të përmirësohet deri diku financimi, do të shkurtojmë listën esenciale të barërave, sepse këtu e kemi parë një zbrazëti, sepse furnizohen me përqindje institucionet shëndetësore, por në kualitet furnizohen edhe me barëra dhe material harxhues që nuk është i domosdoshëm. Pra, do të bëjmë një seleksionim brenda kësaj liste, në mënyrë që ato mjete financiare që harxhohen, të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive dhe efikase.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Lirije Kajtazi, ka pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Parlamentit, zoti Hamiti!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qeveritarë,

Unë kam një pyetje për Qeverinë, përkatësisht ministrin e Punës dhe Mirëqenies, zotin Rashiq, të ngrejë një shqetësim jo të panjohur për Qeverinë. Ditë më parë, disa qytetarë të Kosovës që kanë qenë me punë të përkohshme në Konfederatën Zvicerane dhe që tani kanë arritur moshën për pension, kanë shprehur brengën e tyre se nuk po e gëzojnë të drejtën për kompensimin e gjithë atyre viteve të punës, edhe pse kanë qenë të rregullt në kryerjen e obligimeve ndaj shtetit Zviceran, gjë të cilën e kanë gëzuar më parë qytetarët e Kosovës dhe vazhdojnë ta gëzojnë qytetarët e shteteve përreth. Siç shihet, e tëra kjo po ndodhë për mos kryerjen e detyrave të veta që ka Qeveria e shtetit tonë në raport me shtetet tjera, për të mundësuar që edhe qytetarët tanë të shpërblehen apo të kompensohen për djersën e derdhur me vite në ato shtete, konkretisht në Zvicër. Mendoj se ka mjaftë argatë ekzekutive për t'u marrë me këtë problematikë. Nëse duke bërë ministri mbi ministri përpiqemi t'i themi diasporës se ne po kujdesemi për ju, do të ishte mirë të bëjmë diçka konkrete për ta.

Dhe, në fund, zoti ministër, cilat janë angazhimet tuaja që qytetarët e Kosovës të trajtohen dinjitetshëm dhe sipas meritës për kontributin e tyre? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Ministri Rashiq!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani zamenici premijera,
Kolege ministri,
Dame i gospodo, narodni poslanici,
Poštovana gospodo,

Kao jedan kratak rezime, samo u decembru 2009, je prva informacija izvršna, objavljena od strane Švajcarskih autoriteta da će od 1. aprila 2010. godine biti te penzije koje dobiju naši sugrađani da budu ukinute, odnosno biće suspendovana na jedan određeni način. Od tad, od tog momenta, od tog prvog dana kad smo mi dobili informaciju, prvo što smo radili i sa Švajcarskim ambasadorom na Kosovu, takođe sa našim ambasadorom u Švajcarskoj, reagovali smo na način da uspostavimo jedan dogovor, odnosno utvrdimo momenat kad ćemo se sresti. Ja sam tog dana video odmah ambasadora Švajcarske ovde na Kosovu, informisao sam ambasadora Maljaj u Švajcarskoj, tako da je počeo jedan proces, da tako nazovem, pregovora. Od samog onog prvog našeg predloga je bio predlog za produžetak, odnosno transfer onih kompetencija koje je Kosovo imalo pod ugovorom sa Jugoslavijom u to vreme, da jednostavno budu tehnički prebačene na Kosovu, znači kao novi identitet. I u tom slučaju mi smo stvorili radnu grupu i podneli smo svu našu dokumentaciju, čak smo jednu radnu verziju dokumenta već predali u prvoj toj komunikaciji i došlo je uz jednu sinhronizaciju do sporazuma zajedno sa autoritetima Švajcarske, 2. septembra 2010. godine i u samom Bernu je potpisan jedan sporazum, odnosno protokol. Taj protokol je označavao da trebamo mi uraditi. Pričaću u kratkim crtama da ne bih gubio puno vremena.

Stvaranje jednog registra sa javnim institucijama socijalnog osiguranja na centralnom i lokalnim nivou Kosova, završetak stvaranja pravne infrastrukture koje sprečava eventualne zloupotrebe. Ja moram da naglasim da jedno od primedbi autoriteta

Švajcarske je bilo da bi bilo određenih kršenja zakona, da tako nazovem, individualaca koji su tražili svoja prava sa Kosova. Znači, nekih kršenja pravila individualaca koji su tražili svoja prava sa Kosova.

Pod tri, izveštaj za autoritete Švajcarske koji se takođe podnosi i Evropskoj komisiji u vezi civilnog registra, odnosno stanovništva Kosova.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Më shpejt, se kohën e hëngre!
Jepja kohën, ta vazhdojë ministri!

MINISTRI NENAD RASHIQ: Faleminderit, kryesues!

Četvrta je podnošenje izveštaj za dve publikacije Ministarstva za pravnu infrastrukturu u oblasti zapošljavanja i socijalnog staranja.

I peta, primarna i sekundarna registracija, koja je na snazi na Kosovu onog momenta kad su usvojeni od strane Parlamenta Kosova, znači jednostavno tražili su jednu pravnu osnovu i pravnu bazu i ja mogu odgovorno da tvrdim da smo mi, kao što sam rekao, 2 septembra je bio napravljen sporazum, mi smo u novembru sve tačke što se tiču nas i institucije Kosova, već obavili u samom novembru. Od novembra znači 2010. godine pa do sad mi i dalje čekamo konfirmaciju Švajcarske vlade, da njihova delegacija dođe, jer je tako bilo predviđeno, da prvo naša delegacija ode u Švajcarsku, u Bern, da tamo potpiše ovaj protokol, e sad je bio odnosno jeste red na švajcarce da dođu da ovo već jednom završimo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja Kajtazi, a ke pyetje shitesë?
Lirije Kajtazi!

LIRIJE KAJTAZI: Besoj nuk do të ishte e tepërt ta themi edhe atë se diaspora ka qenë ajo që në një kohë kur na ka munguar shteti, ka mbajtur jetën këtu. Prandaj, dinamizmi i kësaj pune do të ishte një respekt për ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Nemaš pitanje, s'ke pyetje, već në vazhdosh fjalim, si ajo, si ti. Ministri Rashiq, po do të flasë.

MINISTRI NENAD RASHIQ: Naravno, naravno gospodo, uveravam vas da od samog tog početka, da ga tako nazovem problema, ja moram da naglasim, ja sam rekao to i možda više puta javno da, nažalost, postojalo je u jednom momentu možda jedno nerazumevanje od strane autoriteta Švajcarske, shvatam da su neke političke okolnosti u tom momentu bile takve u samoj Švajcarskoj, ali jedno što je vrlo bitno za nas, a takođe bitno i za Švajcarce, je da je jedan slučaj kosovca, jednog koji je žalio Ustavnom sudu, je dobijen. Znači, u međuvremenu, u ovom međuprostoru koji sam ja već naglasio od sporazuma do sadašnjih dana, bio je jedan slučaj gde je naš sugrađanin prijavio to i

Ustavni sud je odlučio u njegovu korist. Znači, ipak jesmo u pravu, bez obzira što tehnički možda imamo nekih poteškoća kroz našu saradnju sa Švajcercima, ali ipak to je potvrda da mi jesmo bili na dobrom putu i da će naša prava, da će prava građana koji žive u Švajcarskoj biti sigurno zaštićena. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Alma Lama, ka pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zonja deputete, a doni ta shtroni pyetjen? Deputetja Alma Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Desha të bëj një dy vërejtje në lidhje me mënyrën se si po shkon kjo kohë e pyetjeve parlamentare. Ministrat po e marrin, ata që janë prezentë e kam fjalën, po e marrin krejt kohën. Përderisa është koha e kufizuar, ju lutem ta keni pak kujdes, se s'ka nevojë kështu për të mbajtur fjalime shumë, domethënë.

Tjetra, po e shoh që ministrat dhe Qeveria s'është më e përgjegjshme, shumica e pyetjeve nuk kanë persona prezentë për t'u përgjigjur. Sidoqoftë, pyetja ime ishte për kryeministrin, por meqë është zëvendëskryeministri, nëse asi preferon të përgjigjet, unë e shtroj pyetjen. Zoti Hajredin Kuqi.

KRYESUESI: A e ke pyetjen për zëvendëskryeministrin, në këtë rast.

ALMA LAMA: Pyetja është për kryeministrin, po nëse zëvendëskryeministri preferon të përgjigjet, e shtroj pyetjen.

KRYESUESI: Unë nuk e di a preferon. A do ta lexosh pyetjen, se unë nuk jam këtu për të bërë kontratë me ju.

ALMA LAMA: Ok, në rregull. Çështja është kjo: Kuvendi i Kosovës, me datë 10 mars 2011, ka miratuar Rezolutën me numër 4001, ku në pikën 9 të saj thuhet, si më poshtë: "Kuvendi i Republikës së Kosovës e rikonfirmon të drejtën kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshkruan Qeveria e Republikës së Kosovës". Ndërkohë, gjithashtu çështja tjetër ka qenë që Qeveria e Republikës së Kosovës, pra në pikën 5 është e obliguar që Kuvendi t'i paraqesë dokumentin themelor të dialogut brenda afatit ligjor. Për sa i përket dokumentit, ne vetëm sot e kemi marrë këtë dokument dhe nuk kemi pasur as platformën më përpara, asgjë deri më tani. Sido që të jetë, pyetja ime ishte kjo: A do t'i sillni këto marrëveshje në Kuvend për ratifikim, ashtu siç thuhet në rezolutën e përmendur më sipër? Por, meqë nga deklaratat kemi marrë vesh se kryeministri, kemi marrë vesh që këto marrëveshje nuk do të vinë në Kuvend, pyetja që shtroj unë, - A i konsideron këto marrëveshje të brendshme apo të jashtme? Kjo është pyetja. Dhe, përderisa nuk ka nënshkrim të asnjë lloji marrëveshjeje, kush do të bëhet garant për t'i implementuar këto marrëveshje, sepse nëse bëhet BE-ja, atëherë çfarë nevojë ka pasur për të zhvilluar dialog me Serbinë, sepse BE-ja mund ta kishte kushtëzuar Serbinë që të plotësojë këto kushte...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

A do kush të përgjigjet? Nuk ka përgjigje!

Nuk kemi më pyetje. Mirë, shumë!

Unë, si drejtues i kësaj seance dhe si njeri i vjetër në këtë parlament, ju lutem, dëgjoni dy fjalë edhe për këtë pikë të rendit të ditës. Ata që bëjnë pyetje dhe ata që kanë marrë me shkrim që do të përgjigjen, ju lutem shumë, ta kenë disiplinën të jenë këtu! Kjo vlen për të gjitha kohët. Edhe e dyta, ekziston një skemë e kohës: pyetja bëhet për 2 minuta, ministri përgjigjet 3, nëse ka shtesë, është 1 minutë, përgjigja tjetër është 2, dhe këtë punë duhet ta dinë edhe deputetët, edhe regjia, edhe të gjithë. Kështu që sekush e ka kohën e vet, është problem tjetër, kush qysh dinë ta shfrytëzojë, se s'di.

Tash, meqë e kemi deputetin Kuleta me pyetje për ministrin Dardan Gashi dhe ministri është i pranishëm, zoti Kuleta e bën pyetjen!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Janë dy çështje. Çështja e Institutit të Kosovës për mbrojtjen e natyrës dhe mungesa e kujdesit për vlerat e rralla të trashëgimisë natyrore, do të thotë të ngërthyera në mes vete, të ndërlidhura. Pyetja e parë është: Në Ligjin për mbrojtjen e natyrës, numër 03/L-233, është paraparë që punët profesionale për mbrojtjen e natyrës për Republikën e Kosovës i kryen Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Ndërkohë që ka vite që ky institucion nuk funksionon, pse ndodh kjo dhe cili është qëndrimi juaj rreth kësaj çështjeje?

KRYESUESI: Ministri Gashi!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputeti Kuleta,

Po u përgjigjem me radhë pyetjeve që i kam marrë me shkrim.

Sa i përket Institutit, e vërtetë është që është paraparë me ligji, ligji që ju e citoni, krijimi i këtij instituti. Ka qenë edhe i formuar ky institut më herët, në vitin 2007 është marrë vendim, për shkak të kushteve buxhetore, që ky institut të inkorporohet në Agjencionin Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit, që është në kuadër të Ministrisë së Ambientit, aty edhe funksion si sektor i veçantë. Ashtu siç është paraparë me ligj, ne vazhdojmë të insistojmë që ky institucion të themelohet, mirëpo mungesat buxhetore vazhdojnë të pengojnë themelimin e këtij institucioni dhe aktivizimin e tij. Në momentin që ministria t'i ketë në dispozicion mjetet buxhetore, do të jetë shumë e lumtur që ta aktivizoj këtë institucion të rëndësishëm.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Gashi!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Agim Kuleta!

AGIM KULETA: Po, domethënë është e saktë ajo që me një vendim, mirëpo pikërisht këtu qëndron problemi. Do të thotë, vendimi është i kundërligjshëm, sepse kjo është një kategori ligjore, e cila mund të..., ky institut mund të quhet vetëm nëse nis procedimi i

ndryshimit të ligjit, ku nuk do të parashihej ky institut. Është marrë një vendim, prandaj unë dëshiroj të di a do të vazhdojë kjo gjendje e kundërligjshme apo do të procedohet ndryshimi i ligjit, sepse gjendja është kundërligjshme, vendimi është i kundërligjshëm, me ligj është paraparë, me vendim shuhet.

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri Gashi!

MINISTRI DARDAN GASHI: Siç thashë, vendimi nuk është i kundërligjshëm, është një zgjidhje e përkohshme, për shkak të mungesës së buxhetit për aktivizimin, për regrutimin e stafit dhe të mjeteve të punës, është pezulluar formimi i institutit, nuk është marrë vendim për shuarjen e institutit, është marrë vendim për pezullimin e funksionalizimit të tij, si institut i veçantë, për sa kohë që nuk i kemi në dispozicion mjetet buxhetore.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

AGIM KULETA: Dy pyetja i pata!

KRYESUESI: Ti mundesh edhe 100 t'i kesh, po këtu një pyetje e ke o zotëri, unë nuk di çka është puna e juaj. Unë e kam në regjistër që ti e bën një pyetje. Ti e paske edhe pyetje, urdhëro bëre pyetjen tjetër, por s'kam në regjistër, ti mund ti kesh, unë nuk i kam. Zoti Kuleta, edhe një pyetje e ka.

AGIM KULETA: Faleminderit!

Pse nuk menaxhohen dhe nuk mbrohen vlerat e ralla të trashëgimisë natyrore, si për shembull Shpella e Gadimes, Rezervati strikt i natyrës në Grykë të Rusenicës, bifurkacioni i Lumit Nerodime. Çdo ditë Shpella e Gadimes, Rezervati strik i natyrës në Grykë të Rusenicës shkatërrohet nga minimet e gurëthyesve, që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ju ka dhënë pëlqim mjedisor. Në Rezervatin strikt të natyrës në bifurkacionin e lumit Nerodime ka ndërtime ilegale. Në brendi të Shpellës kanë mbirë këpurdha, janë krijuar myshqe, shkruhen grafitë, ka shembje të dheut, ndriçimi është shumë i dobët, gjë që paraqet edhe rrezik për vizitorët. E për më tepër, dëmtohen edhe fizikisht aragonitet, si vlerë e veçantë e Shpellës së Gadimes. Prandaj, pse nuk menaxhohen, pse lejohen gjithë këto dëmtime?

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i jam mirënjohës deputetit Kuleta për shtruarjen e këtyre pyetjeve. Me radhë, sa i përket bifurkacionit në Lumin Nerodime, ky është në mbrojtje të Kuvendit Komunal të Ferizajt, kurse roli i ministrisë është konsultativ, kështu që sa i përket bifurkacionit, kompetencat për zhvillimin e mëtutjeshëm dhe mbrojtjen janë të komunës së Ferizajt.

Sa i përket Rezervatit të Rusenicës, ai është në brendësi të Parkut nacional "Sharr" dhe mbrohet me ligj, si i tërë parku nacional.

Kurse, sa i përket Shpellës së Gadimes, duhet të pajtohem plotësisht me deputetin se është në gjendje të turpshme, se çka ndodh atje dhe çka ka ndodhur atje. Do të thotë, ai rezervat është në mbrojtje me ligj prej vitit 2009, mirëpo nuk është arritur aty as nga komuna e Lipjanit, as nga Qeveria që të arrihet të vendoset rendi dhe një drejtori e përgjegjshme. Prej vitit 2008 ne nuk kemi asnjë raport se çka ndodh aty, sa duhet. Ministria e ka një raport nga një grup punues i posaçëm, që është themeluar për Shpellën e Gadimes, dhe ne kemi ardhur në përfundim se e vetmja mënyrë që kjo të mbrohet është që t'i jepet në menaxhim me anë të dhënies me koncesion ndonjë kompanie ose institucioni përgjegjës dhe të largohet nga menaxhimi ilegal i cili ndodhë aty që sa vite. Do të thotë, sa i përket kësaj, këtu Qeveria, në konsultim edhe me ministrinë tjera, ka marrë vendim që kjo t'i dërgohet partneritetit publiko-privat dhe të shikohet mënyra që të gjendet një investitor, që do të merret me menaxhimin e shpellës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministri Thaçi mbrohet nga ligji, por problemi është që nuk po zbatohet ligji, se me ligj është e mbrojtur, është e vërtetë, por këtu është problemi që nuk po zbatohet ky ligj. Edhe për më tepër, jo që nuk po veprohet, por po veprohet në drejtim të gabuar. Jepet pëlqimi mjedisor, për shembull për ndërtimin e një gurthyesi, në distancë ajrore 200 metra nga Shpella e Gadimes. Edhe kjo është një prej shkaktarëve të këtij dëmtimi që i bëhet aragoniteve në Shpellën e Gadimes. Do të thotë, i jepet pëlqim mjedisor një faktori që shkatërron pasurinë natyrore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka ministri Dardan Gashi.

MINISTRI DARDAN GASHI: Është e vërtetë se janë në operim tre gurthyes në atë regjion, dhe vendimi i Ministrisë është se ato licenca do të revokohen edhe në konsultim me Agjencionin për Miniera, se ato nuk kanë, ato licenca e dëmtojnë atë pronë, e dëmtojnë atë vlerë natyrale dhe turistike të Kosovës. Dhe, siç thashë, ne jemi duke e përgatitur gjithë Shpellën e Gadimës dhe regjionit që të përgatitet për një investim, një investitor të përgjegjshëm dhe që të menaxhojë me atë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Këtu një shpjegim zotit Kuleta për të qenë korrekt deri në fund. Ti e ke shkruar një shkresë, por i ke dy pyetje në një letër, proceduralisht shkruhen dy, prandaj të kanë regjistruar 1. Kjo është krejt. Po edhe ashtu, në një mbledhje, me Rregullore, dy ke drejtë t'i bësh, kështu që besoj disi mbërritëm edhe me ministrin Gashi të bëhemi bashkë edhe të provojmë të marrim përgjigje.

Ne tash i presim deputetët të hyjnë në sallë. Pushim nuk do të jap. Këta që janë duke pirë kafë, le të kthehen!

Në sallë i kemi 62 deputetë. Vazhdojmë me punë. Pika është:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit, të mbajtur më 30 qershor 2011

Të nderuar deputetë, ju pyes a keni vërejtje në procesverbal?

Nuk ka vërejtje.

Atëherë, konstatoj që Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 30 qershor 2011.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendi i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, ta paraqesë para deputetëve dhe Kuvendit, si dhe ta arsyetojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë, zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës të Kosovës dhe të Ministrisë të Drejtësisë të paraqes para jush Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

Ministria e Drejtësisë, në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore, në sektorin e saj ka përgatitur këtë projektligj, i cili rregullon përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, sanksione të cilat mund të caktohen dhe rregullat e procedurës, në të cilat mund të vendoset për ata. Natyrisht, me këtë projektligj parashihen edhe procedurat për nxjerrjen e vendimit, dhënia e të dhënave dhe evidencave të dënimeve, parashkrimi, pushimi i masave të sigurisë dhe pasojat juridike të dënimit dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, që është në fuqi tanimë, i vitit 2003, si ligj organik në fushën e të drejtës penale, i cili rregullon veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm, me nenin 106 ka paraparë që veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale dhe masat e tjera të posaçme që rregullojnë procedurën penale, duhet të rregullohen me një ligj të veçantë.

Legjislacioni ekzistues i Kosovës ka njohur institutin e përgjegjësisë së personave juridikë, por ajo përgjegjësi është vendosur që për kundërvajtjet dhe deliktet

ekonomike, ndërsa për ekzekutimin e veprave penale ka qenë përgjegjës personi juridik në kuadër të afarizmit të tij për veprën që e ka kryer.

Ekziston një zbrazëti juridike në fushën e përgjegjësisë të personave juridikë. Juridikisht ka qenë e pamundur deri më tani të procedohet nëpërmjet procedurës penale, veprimet kundërligjore dhe proceduat për personat juridikë. Këtu mendohet, para së gjithash, për ato veprime dhe procedura të personave juridikë, pastaj te personave përgjegjës në personin juridik, të cilat përmbajnë elemente të veprave penale.

Kuptimi i vendosjes së përgjegjësisë penale të personave juridikë përbëhet në nevojën për reagim për ato vepra penale të ashtuquajtura vepra penale tipike, të cilat personat juridikë gati rregullisht i kryejnë, ndërsa për këto penalisht nuk janë përgjigjur.

Situatën e tillë juridike apo, më mirë ta them, zbrazëtirën juridike, është paraparë që të zgjidhë me këtë ligj përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale. Ky projektligj tenton që në mënyrë të plotë të rregullojë, si në aspektin material të përgjegjësisë penale të personave juridikë, edhe në aspektin procedural, duke paraparë rregullat e procedurës penale gjatë zhvillimit të procedurës kundër personave juridikë të pandehur dhe sanksionet penale të cilat mund t'u caktohen atyre.

Projektligji për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, do të paraqesë një risi në legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe miratimi i tij është një sukses që të luftohet kundër kriminalitetit të organizuar dhe korrupsionit.

Në legjislacionin kosovar kjo fushë juridikisht ka qenë e normuar, ndërsa me miratimin e këtij ligji do të plotësohet dhe do të hiqet nga fuqia Ligji për deliktet ekonomike, i cili është ende në fuqi “Gazeta Zyrtare” e ish-Jugosllavisë e vitit 1986. Andaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që sugjerimet tuaja, vërejtjet, t’i jepni në parim, pastaj ta harmonizojmë, i cili është edhe ligj që parashihet me Raportin e Progresit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër dhe zëvendëskryeministër Kuçi! Tash, sipas radhitjes, fjalën e merr kryetari i Komisionit funksional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues! Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar ligjin dhe e vlerëson si pozitiv dhe kërkon nga seanca që të procedojë me të. Parimisht, jemi dakord dhe do të shohim pastaj nën për nen, në mbledhjet e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fillojmë diskutimet me përfaqësues ose shefa të grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim ka vendosur që të japë përkrahje, duke trajtuar si një projektligj i cili plotëson

kornizën ligjore penalo-juridike dhe plotëson edhe obligimin ligjor që ka dal nga Kodi Penal.

Edhe zëvendëskryeministri në arsyetim e sqaroi mirë natyrën dhe objektin e këtij projektligji, pra është një projektligj specifik, që në rastin konkret na paraqitet si ligj special karshi ligjeve organike, karshi Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Objekt i trajtimit të këtij ligji është një fushë e kufizuar, ajo rregullon kryesisht përgjegjësinë penale të personave juridikë, që deri me tash ka qenë kryesisht e natyrës së delikteve ekonomike apo kundërvajtjeve ekonomike, por edhe në shtetet tjera që kanë aderuar në Bashkimin Evropian, apo ato që po pretendojnë, është vendosur që kjo materie të rregullohet me legjislacion penal, kështu që me këtë projektligj, në fakt, plotësohet plotësisht korniza ligjore, rregullohet kjo materie shumë e rëndësishme. Të kujtojmë, në dy raportet e fundit të Progresit është kërkuar miratimi i këtij projektligji, natyrisht, në leximin e dytë ka shumë çështje që mund të jenë objekt i diskutimeve, në mënyrë që ky projektligj të plotësohet dhe të ndryshohet me propozime konkrete.

Edhe një herë grupi parlamentar, në parim e përkrah dhe angazhohet që në leximin e dytë të japë kontributin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bajrami!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, profesor!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

E kam marrë parasysh që kjo fushë në Kosovë nuk ka qenë e mbuluar me ligj të veçantë edhe pse disa aspekte të kësaj fushe janë mbuluar me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe kodet e procedurës penale. Duhet të them që në fillim se grupi parlamentar, pasi që e ka shqyrtuar, mendon që edhe t'i japë përkrahje në parim.

Po më lejoni t'i them disa vërejtje parimore, të cilat mendojmë që në procedurat e mëtutjeshme, të plotësojnë këtë ligj, i cili është i rëndësishëm të veçantë. Vërejtja e parë që ka të bëjë me përkufizimet e dy shprehjeve kryesore të këtij ligji që janë dhënë në nenin 2 të projektligjit, fjala është për shprehjen: “person përgjegjës”, e cila është përkufizuar në mënyrë të paqartë e sidomos i paqartë është përkufizimi i pjesës së dytë, kur përmendet edhe shprehja ” person zyrtar” - andaj më e mira është që shprehja “person përgjegjës”, të përkufizohet në mënyrë më të qartë duke pasur për bazë këta komponentë: a) besimin e detyrave të caktuara, në kuadër të personit juridik, autorizimin për të vepruar në emër të personit juridik, bazueshmëria e madhe se sa është i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik, dhe veprimi i aksionarit në emër të personit juridik.

E dyta, edhe shprehja ” person juridik” është përkufizuar jo në mënyrë të qartë, sepse përkufizimi fillon kështu: “Person juridik do të thotë personi fizik i cili vepron

individualisht e tjerë”, që do të thotë që në fillim shkakton një konfuzion, duke përzier personin juridik me atë fizik.

Në nenin kur flitet për bazën dhe kufirin e përgjegjësinë se personave juridik, në paragrafin e parë thuhet: “Personi juridik është përgjegjës për veprë penale të kryer me qëllim që personi juridik të realizojë ndonjë dobi.” Mirë është që për ekzistimin e veprës penale, qëllimi i realizimit të dobisë, të zgjerohet edhe për personat e tjerë, qofshin ata fizik apo juridik, sepse mund të ketë raste që personi përgjegjës të veprojë për dobinë e personave të tretë, të cilën dobi mund ta përvetësojë dhe ta ndajnë bashkërisht.

Një vërejtje tjetër, e cila ka të bëjë me nenin 7, në tekst nuk qartësohet vepra penale e vazhdueshme dhe mendojmë që aty ku nuk është, duhet të, të hiqet fjala: “është” dhe “është veprë penale e vazhdueshme”.

Dhe, vërejtja fundit ka të bëjë me nenin 8 –dënimi me gjobë. Gjoha duhet të rregullohet, është mendimi ynë, duke marrë parasysh edhe praktikën më të mira të tjera ndërkombëtare, të cilat e kanë rregulluar këtë çështje. Ne mendojmë që janë të ulëta dhe të cilat është më se e arsyeshme që të jenë në nivel me vendet demokratike dhe të cilat luftojnë në mënyrë sistematike krimin dhe korrupsionin. Andaj, mendojmë që gjobat duhet të ngritën në nivel të vendeve edhe të rajonit edhe në vendet ku disa shtete kanë edhe pesëfishin, domethënë, limitin. Dhe, për fund, inkurajojmë Ministrinë e Drejtësisë që Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale, të vijnë në afatin sa më të shpejtë, sepse e plotëson gjithë këtë strukturë ligjore, të cilën, kohëve të fundit, jemi duke paraqitur për aprovim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe një herë, shprehi gatishmërinë e Grupit Parlamentar dhe deputetëve në Komisionin funksional, që të angazhohen në mënyrë më të mirë për amendamentin e këtij ligji. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj!

Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, Grupin e saj, Albulena Haxhiu

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka analizuar dhe shqyrtuar Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale. Gjatë shqyrtimit, kemi hasur në disa të meta, të cilat shkurtimisht do t’i paraqes me radhë.

Neni 4, paragrafi 3: ”përfshirja e organeve të vetëqeverisjes lokale, nga çdo formë e përgjegjësisë penale”- mendojmë se është i gabueshëm. Përfshirja duhet të kufizohet vetëm në vepra të cilat janë bërë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, por mund të lehet mundësia që ato të jenë përgjegjëse për veprat të cilat dalin jashtë kornizave të funksioneve të tyre.

Neni 9, paragrafi 1: ”Dënimi me gjobë maksimale prej 100.000 euro, për veprat penale ekuivalente me burgim afatgjatë”, është shumë i ulët dhe duhet të jetë më i lartë.

Shuma maksimale, mund të shkojë nga 300.000 deri në 500.000 euro. Këtu ndoshta duhet përmendur procesi i privatizimit që përcillet me jo transparencë, prandaj gjoha maksimale duhet të jetë më e lartë. Dënimet e tilla janë minimale dhe në krahasim me pasojat e shkaktuara nga veprimet e tilla kriminale.

Neni 25, paragrafi 2: “Për shkak të ekonomizmit të procedurës, personi juridik dhe personi përgjegjës mund të kenë një mbrojtës, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e mbrojtjes së tyre”. Mendojmë se edhe këtu duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit të procedurës penale, ku nuk lejohet që një avokat mbrojtës, të përfaqësojë më tepër se një klient, në mënyrë që të mos lihet asnjë mundësi për mbrojtje joefikase të ndonjë të pandehuri.

Po ashtu praktika e vendeve në rajon, tregon se prokurori ka diskrecion që të mos ndërmarrë ndjekjen, nëse asetet e kompanisë nuk janë të mjaftueshme për t’i mbuluar shpenzimet e procedurës. Kjo besojmë se duhet të jetë e përfshirë në ligj, në mënyrë që të mos ngarkohen pa nevojë gjykatat edhe ashtu janë të stërngarkuara.

Edhe pse përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, do të ishte e udhës që në ligj të parashihen dispozitat me të cilat rregullohen masat gjatë hetimeve, si për shembull: ngrirja e asetëve, llogarive bankare, në mënyrë që mos t’i lejohet kompanive që gjatë procedurës të tjetërsojnë asete të cilat janë fituar nga veprimtaria kriminale.

Pra krejt në fund, ne do të votojmë në parim të këtij projektligji dhe vërejtjet tona do t’i adresojmë në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka bërë shqyrtimin e Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale dhe mendon që është një projektligj i një rëndësie të veçantë dhe e plotëson kornizën ligjore, andaj në parim do ta votojmë dhe ndihmesën tonë do ta japim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për Aleancën, Koalicionin Kosova e Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re, e ka shqyrtuar Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale. Në parim e mbështesim projektligjin dhe kontributin tonë konkret do ta japim në komisionet përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!
Parlamentarna grupa „6+“ analizirala je ovaj nacrt uz propratne dokumente i memorandum objašnjenja. Vidljivo je u definicijama da se odstupilo od klasične podele na pravno lice i odgovorno lice. Pravno lice je određeni privredni subjekt, a odgovorno lice je lice koje obavlja određenu funkciju u njemu, radi se o rukovodećim funkcijama.

Ovo spominjemo jer u definicijama u članu 1. tačka 1. i tačka 2, gde se u oba slučaja govori o odgovornim licima koje imaju rukovodeći položaj. Ovde se stvari moraju malo jasnije definisati, a u tu svrhu je potrebno videti zakone susednih zemalja. U daljem tekstu nacrt je nejasan, treba se detaljno razjasniti, te zatražiti dodatna objašnjenja, jer ovo je nešto novo u kosovskom zakonodavstvu. Takođe se mora jasnije gramatički formulisati i ispraviti greške.

Parlamentarna grupa „6+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona o odgovornosti pravnih lica za krivična dela. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Për SLS nuk është paraqitur kurrkush.

Nuk ka të tjerë që dëshirojnë të diskutojnë në parim për këtë projektligj. Zoti zëvendëskryeministër, a e do fjalën? Nuk e kërkon fjalën!

Pasi hyri Hydajeti, u bëmë 61 deputetë. Dhe, unë, para se të votojmë, po ju them edhe një herë, pa 61 s’votohen ligjet, përgjegjësi ka çdo deputet, por mazhoranca ose shumica le ta dinë që me 30 deputetë në Parlament, s’ marrin vendime e as nuk bëjnë ligje. Kaq.

Votojmë tash për ligjin.

(Ndërprerje e incizimit)

... Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështje penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që edhe në emër të Qeverisë së Kosovës, të paraqes edhe këtë projektligj për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Dispozitat e Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, i kanë për bazë dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konventat e Këshillit të Evropës që mbulojnë fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, praktikat e vendeve të rajonit, të cilat kanë kaluar në të njëjtin proces dhe në të cilin është duke kaluar Kosova.

Ministria e Drejtësisë, gjatë hartimit të këtij projektligji ka marrë për bazë rekomandimet dhe sugjerimet e Këshillit të Evropës, të Komisionit Evropian, OSBE-së, EULEX-it, dhe faktorëve të tjerë vendor dhe ndërkombëtar.

Ky projektligj ka për qëllim plotësimin dhe rregullimin e bazës ligjore, për ofrimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale. Fushat të cilat rregullohen me këtë projektligj janë: ekstradimi; transferimi i personave të dënuar, bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale, transferimi i përkohshëm i të pandehurve, ekzekutimi i vendimeve të huaja, transferimi i ndjekjes penale, marrja në pyetje përmes formave moderne të telekomunikimit, arrestimi i përkohshëm i personave të kërkuar ndërkombëtarisht e tjera.

Me këtë projektligj do të tejkalohen vështirësitë dhe do të lehtësojmë punën për Ministrinë e Drejtësisë dhe për organet tjera gjyqësore në Kosovë, që ndërlidhet me ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare, duke pasur parasysh se deri me tani këto dispozita kanë qenë të rregulluara në mënyrë të përgjithshme me Kodin e Procedurës Penale.

Ky projektligj, është përgatitur nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar dhe përfshin sistemin juridik të Kosovës, që të arrihen, ndër të tjera, qëllimet e shumta në luftimin e kriminalitetit ndërkombëtar. Ju ftoj, të nderuar deputetë, duke falënderuar për mbështetjen paraprake të ligjit të kaluar, që ta mbështetni edhe këtë ligj në parim dhe unë dhe Ministria e Drejtësisë, do të bashkëpunojmë ngushtë me ju në përmirësimin dhe hartimin e tij final për lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Fillojmë diskutimin në parim të projektligjit të paraqitur.

I pari fjalën e merr kryetari i Komisionit funksional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar në parim projektligjin e propozuar dhe mendon se duhet të kalojë në parim dhe fton deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tash do t'i dëgjojmë mendimet e përfaqësuesve ose shefave të grupeve parlamentare.

Për Grupin Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i pajtimit që projektligji të aprovohet në parim. Sugjerimet dhe amendamentet e mundshme, do t'i bëjmë më vonë, në proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për Grupit Parlamentar të LDK-së, flet deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Sa i përket Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne jemi dakord që ky ligj të kalohet në parim, mirëpo me disa vërejtje substanciale, sa i përket këtij ligji.

Në vërejtjet kryesore që i kemi me këtë ligj janë konceptet juridike që janë përdorur këtu. Ka ngatërrim të koncepteve herë pas herë dhe flitet për koncepte të ndryshme. Në të njëjtin ligj, diku flitet për lutje dhe diku flitet për kërkesë dhe duhet të kemi parasysh se a bëhet fjalë për lutje apo kërkesë, sepse është një parim shumë i rëndësishëm në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare, sepse po flasim për çështjet e ekstradimit dhe çështjet e bashkëpunimit penal ndërkombëtar? Dhe, te elementet e tjera të rëndësishme, që janë, që duhet t'i kushtohet kujdes në këtë rast, kujdes shumë i veçantë, është bashkëpunimi për krimet e luftës, ose ekstradimi i personave të kërkuar për krime lufte, se mund të kemi rast, jo vetëm për krimet e luftës që janë zhvilluar në Kosovë, por edhe për luftërat tjera që janë zhvilluar, ose do të mund të zhvillohen në vende të tjera dhe këto raste, në qoftë se vjen dikush edhe kërkon strehim politik në Kosovë, se si do të jenë procedurat të cilat duhet t'i trajtojë Kosova? Prandaj, duhet t'i kemi parasysh që në këtë ligj, në qoftë se ka kërkesa për ekstradim, për personat të cilët kërkohen ndërkombëtarisht për krime lufte, Kosova duhet të marrë apriori vendimin që këta persona duhet të ekstradohen dhe të mos krijojë kushte për mbrojtjen e këtyre personave.

Pastaj, janë elemente tjera që duhet të trajtohen dhe do të trajtohen në Komisionin funksional, ku edhe unë jam kryetar i këtij Komisioni, mirëpo duhet të kemi parasysh se si LDK, ne jemi shumë të vendosur që të krijojmë kushtet mbi bazën e të cilave do të krijohen edhe marrëdhëniet e bashkëpunimit penal ndërkombëtar në mes të Kosovës dhe vendeve tjera, sidomos në fushën e ekstradimit dhe të krijohen mundësi, që institucionet e

Kosovës, të hyjnë edhe në marrëdhënie bilaterale, të nënshkruajnë marrëveshjet e ekstradimit dhe çështje tjera. Prandaj, mendojmë se është një ligj shumë i rëndësishëm, por duhet të kihet parasysh specifikat karakteristike që ndikojnë në sistem dhe të krijohet një marrëdhënie bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar, e cila duhet të jetë një marrëdhënie e sigurtë dhe në kuptimin e mbrojtjes edhe të interesit të qytetarëve të Kosovës, mirëpo edhe mbrojtjes të autoritetit të institucioneve të Kosovës në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos në rastet specifike për krimet e luftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Lëvizjen, Grupin e Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne si grup parlamentar kemi analizuar me një rëndësi të veçantë Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Ajo që është shqetësuese, e që do të duhej të përfshihet në këtë projektligj, është pjesa që specifikon se çka do të ndodhë me rastet e krimeve të luftës dhe të arrestuarave, sipas fletë- arresteve të lëshuara nga Serbia?

Ky projektligji synon që të zgjerojë fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar juridik, përtej formës që tanimë është e paraparë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Projektligji synon që të rregullojë bashkëpunimin e ashtuquajtur horizontal me shtetet tjera dhe nuk përfshin bashkëpunimin vertikal me institucionet ndërkombëtare të drejtësisë, si: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Gjykata Ndërkombëtare Penale, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo Gjykata e Përkohshme Penale për ish-Jugosllavinë.

Duke pasur parasysh se Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Penal, janë po ashtu në fazën e amendamentimit, duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm që të bëhet harmonizimi i mirëfilltë i këtyre ligjeve, si në aspekt të përmbajtjes, ashtu edhe të shprehjeve që përdoren, për të mos krijuar konfuzion në praktikë. Po ashtu, duhet të kemi parasysh faktin se prej 1 janari 2013, do të kemi strukturë të re të sistemit gjyqësor dhe prokurorial si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të dispozitave të caktuara të Ligjit mbi gjykatat dhe Ligjin mbi Prokurorinë e Shtetit.

Ky projektligj rregullon vetëm atë pjesë të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, që me marrëveshjen ndërkombëtare, nuk është caktuar ndryshe, apo nëse nuk ekziston marrëveshja ndërkombëtare. Siç thuhet në nenin 1, paragrafi 1, përpos të këtij parimi të primatit të marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas mendimit tonë, duhet shtuar se ndihma juridike ndërkombëtare, ofrohet në pajtim me parimet e sistemit kombëtar juridik, parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe me parimet e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Po ashtu, duhet të sqarohet se si do të veprohet në bashkëpunim juridik ndërkombëtar me shtetet që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, kur ky bashkëpunim kryhet përmes EULEX-it. Do të thotë- cilat dispozita do të vlejnjë për ato raste?

Sa i përket anës gjuhësore, versioni në gjuhën shqipe kërkon lekturim të mirëfilltë. Pra, ne si grup do ta votojmë në parim këtë projektligj dhe vërejtjet tona do t'i adresojmë në komisionet përkatëse.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete,
Për Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim do ta votojë këtë projektligj se mendon se me këtë projektligj është bërë rregullimi i bazës ligjore në çështje kaq të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Për Grupin Koalicionin Kosova e Re, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryesues!
Koalicioni për Kosovë të Re, ka shqyrtuar Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale. Konsiderojmë se është një projektligj i rëndësishëm së veçantë, të njëjtin e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Për Grupin Parlamentar “6+” deputetja Myfera Shiniq.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim

Ceza Kanunları üzerine Uluslararası Hukuk İşbirliği Yasa Tasarısının analize edildikten sonra çevre, ülke yasalarıyla karşılaştırdığımızda, ortak noktaları görüyoruz. Bu Yasa Tasarısı ayan bir şekilde işlenmiş olduğu için Komisyonlarda yapılacak olan çalışmalarla şekillenecektir.

Uyarı ve katkılarımızı komisyonlarda sunarak, 6+ Parlamenter Grubu bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul ettiğini bildirmekteyiz.

Teşekkür ederim

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën dhe, kush është brenda, le të vjen në sallë!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit!
I nderuar nënkryetar,
Të nderuar ministra dhe zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e përshëndes sjelljen në Kuvend të këtij ligji, e konsideroj si shprehje të procesit të subjektivitetimit të Republikës së Kosovës, që natyrisht nënkupton edhe bazën adekuate ligjore. Kosovës i duhej një ligj i tillë dhe ajo që është e mirë dhe do të dëshiroja ta theksoj, është një ligj i shkruar mirë dhe është e natyrshme, është sponsor Ministria e Drejtësisë dhe i takon Ministrisë së Drejtësisë që të jetë edhe model për hartimin e ligjeve, gjë që s'ka qenë përpara dhe kishte efekte jo të këndshme.

Është e qartë që gjatë hartimit të ligjit janë shfrytëzuar përvojat e përparuara të vendeve tjera, gjë që është mendoj e natyrshme dhe e pakontestueshme. Ajo që unë kisha ndërmend të potencoj e thanë edhe parafolësit, është nevoja që edhe përvojat e përparuara të vendeve tjera të harmonizohen me specifikat kosovare. Në këtë frymë mendoj se ka nevojë që vëmendja gjatë procesit të mëtejshëm të përqendrohet edhe në 2 – 3 çështje, që unë do të dëshiroja t'i shtroj.

Duke mos harruar faktin që Kosova është një vend i sapodalë nga lufta, që kishte një të kaluar të rëndë represive, gjenocidale, madje edhe me një të sotme problematike, një republikë e kontestuar dhe objekt i kontestimit të përhershëm, madje edhe shoqëruar me forma të luftës speciale edhe në fushën që rregullon ky ligj. Prandaj, mendoj që kjo specifike, duhet të merret edhe më shumë në konsideratë gjatë amendamentimit të ligjit.

Ligji ka përjashtuar, siç thuhet vendet në të cilat ose rastet në të cilat supozohet se mund të jenë objekt i torturave e shkeljeve të drejtave të njeriut, por është çështje si do të vlerësohet. Nuk ka asnjë vend që thotë se shkelim të drejtat e njeriut dhe praktikojmë torturat. Prandaj, mendoj se duhet të jenë dispozita që pastaj edhe nuk lënë vend për interpretime të ndryshme gjatë zbatimit të praktikë.

Po ashtu, është mirë që është përjashtuar, janë përjashtuar veprat politike, por nuk është shpjeguar çka janë, çka nënkuptohet me veprat politike dhe mendoj se është çështje që duhet të rregullohet. Janë përjashtuar, sidomos prej veprave politike, siç thuhet në nenin 12, paragrafi 2, vrasja ose tentimi i vrasjes së presidentit e tjera, por me kaq mbetet, thua se këta të tjerët mund edhe të trajtohen më ndryshe. Megjithatë ka një dispozitë të mëvonshme që flet për aktet gjenocidale, terrorit e tjera, por ato janë me një kontekst tjetër që mund edhe të ndërlikohet gjatë interpretimit, sepse thuhet në këtë paragraf, nuk do të zbatohet paragrafi paraprak. Mendoj që është një formulë që nuk është e zakonshme. Gjuha duhet të jetë më juridike dhe mund të jetë duke e përfshirë në pjesën, si të thuash, në të cilat përjashtohet, ose duke e thënë më qartë dhe më shkurt. Besoj që në procesin e amendamentimit, kjo do të rregullohet.

Mendoj që, siç u tha edhe më parë, një kujdes i veçantë edhe në hartimin e ligjit edhe në amendamentimin duhet t'i kushtohet kujdes mundësisë së abuzimit të këtij nga dashakeqët e Republikës së Kosovës, sidomos me akuza të kurdisura ndaj pjesëtarëve të luftës së armatosur në Kosovë, me theks të veçantë, sepse ndoshta për këtë kategori edhe janë rregulluar dispozitat me atë domicilitetin e tjera, që edhe e parandalojnë, por do të duhej pasur parasysh faktin se ka edhe në Kosovë qytetarë që nuk janë banorë të Kosovës, ose nuk kanë qenë banorë të Kosovës, nuk janë shtetas të Kosovës dhe mund të jenë objekt i abuzimit edhe me dispozitat e këtij ligji. E merreni me mend, e kam

fjalën kryesisht për qytetarët e ikur nga Lugina e Preshevës, Bujanovcit, Medvegjes e tjerë, të cilët edhe kanë qenë objekt i abuzimit në këtë mënyrë. Tani është e një problem, ta zëmë në Zvicër, me një të ri, Shemsi Nuhun, nëse s'e kam gabuar emrin, i cili pikërisht mbi këto baza edhe mbahet pa të drejtë në gjendje arresti dhe rrezikon të ekstradohet në Serbi, atje edhe ku i janë kurdisur akuzat politike. Mendoj që ligji duhet të parandalojë këtë mundësi abuzimi edhe me veprimtarët nga Lugina e Preshevës.

Neni 14, po ashtu merret me veprat, për të cilat supozohet se mund të shqiptohet dënimi me vdekje. Në leximin tim, kjo mund të jetë ndesh me nenin 12 edhe mendoj që duhet të harmonizohet, kurse duhet parë edhe a mund, apriori si thuash të prejudikohet se çdo vepër që mund të dënohet me vdekje, s' do të thotë që është edhe e tillë që mund të përjashtohet ekstradimi dhe besoj që me këtë do të evitohej një praktikë, që praktikisht të pamundësohet ekstradimi me vendet që e kanë dënimin më të lartë në legjislacionin e tyre penal.

Unë besoj se këto do të korrigjohen gjatë procesit të amendamentimit dhe si e tillë, e mbështes ligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!
E fundit është Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Këtij projektligji, po ashtu i është bashkëngjitur edhe vlerësimi i ndikimit buxhetor, domethënë të Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështje penale. Dhe, nga kjo deklaratë e ndikimit buxhetor, vërehet se ky projektligj ka implikime buxhetore dhe ndikime buxhetore për vitin 2011-2012 dhe 2013 diku në vlerë prej 300.000 eurove.

Sipas kësaj deklarate, këto implikime shtesë buxhetore nuk janë të përfshira as në buxhetin e vitit 2011, por nuk janë të përfshira as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012-2014. Prandaj, që të ketë mundësi që ky projektligj të kalojë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, duhet që ne të kemi një deklaratë nga Ministria përkatëse, sponsorizuese e këtij projektligji se këto shpenzime janë të parapara në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe janë të planifikuara, do të planifikohen, të paktën, për vitin 2012. Përndryshe, do të kemi vështirësi në kalimin e këtij projektligji në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Dhe, kisha sugjeruar Qeverinë që, me qenë se e ka strategjinë legjislative dhe për secilin ligj mund ta di përafërsisht se çfarë kosto shtesë buxhetore kanë, që këto, këtë kosto ta përfshijnë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012 dhe 2014, sepse përndryshe këto projektligje nuk do të kalojnë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonjë!
Nuk kemi deputetë të tjerë për diskutim.

Zoti zëvendëskryeministër, urdhëro!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nëse më lejohet dy-tri çështje që u ngritën nga deputetët e nderuar, fillimisht duhet të falënderoj për mbështetjen, po e them unanime, dhe kjo tregon që qasja ndaj drejtësisë është e përbashkët.

Më lejoni që zoti Gashi përmendi disa lëshime që do t'i përmirësojmë me siguri dhe duhet ta pranojmë që kemi bashkëpunuar edhe me ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë dhe në momente të caktuara terminologjia është e re. Çdo bashkëpunim që parashihet në këtë, është e paraparë edhe me konventat e Këshillit të Evropës, por ne, pasi s' jemi anëtar i Këshillit të Evropës, duhet të shkojmë në këtë formë, në momentin që bëhemi anëtar i Këshillit të Evropës, me automatizëm, pastaj marrim edhe të drejtat dhe obligimet.

Sa për informatë që e përmendët edhe ju, unë i kam bërë disa marrëveshje ndërkombëtare në këtë fusha, me tri valë, nëse më lejohet të them, e para me shtetet fqinje, tanimë e kemi realizuar me Maqedoninë, me Shqipërinë, me Malin e Zi jemi shumë afër, me Kroacinë dhe Slloveninë, ndërsa presim shumë. Edhe me Turqinë e kemi përfunduar, presim që në valën e dytë të jemi me shtetet anëtare të BE-së dhe të SHBA-ve dhe në valën e tretë, në shtete ku ka qarkullim më shumë të mallrave, shërbimeve, të individëve nga vendi ynë, sikur që është Turqia, që kemi përfunduar, por edhe ndonjë vend tjetër.

Ju e përmendët një theks të veçantë që ka të bëjë me krimet e luftës dhe unë dua të them që, çështjet që janë parapara me Konventën Evropiane dhe e dyta ekstradimi, në cilindo rast është i shqyrtuar veç e veç. Edhe tani bëjmë ekstradime të rasteve, por gjithmonë aty ku janë në përputhje me ligjin në fuqi të Kosovës dhe me konventa ndërkombëtare, por nuk është një marrëveshje e cila blanko i garanton dikujt që do të ekstradohet qytetari ynë apo e kundërta, qytetari i shtetit tjetër, por secili rast shqyrtohet veç e veç dhe pas vendimeve adekuate gjyqësore, ne bëjmë veprime të tilla.

Sa i përket bashkëpunimit me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, është një sfidë, dhe në këtë sfidë ka pasur kërkesa nga EULEX-i. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën gjyqësore, por cilindo rast, është kompetencë e plotë e jona. Ne mund dhe duhet të jemi në cilindo rast të njoftuar për veprimet e tilla, dhe deri me tani, unë po e them që ka pasur raste që kanë bërë bashkëpunim pa neve, e them publikisht, ia kam thënë edhe në takime, por në asnjë rast unë nuk do të nënshkruaj ndonjë rast të ekstradimit ose formave të tjera nëse nuk e ka një pëlqim paraprak nga institucionet tona. Dhe, e përmendi zoti Hyseni edhe në kuptimin e veprave politike, natyrisht, që këtu ka të bëjë me shtetet të cilat regjimi i tyre është i dallueshëm prej regjimit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Po, unë jam i bindur që në këtë rast, do të jemi korrekt, ndërsa sa i përket dënimit me vdekje, me Protokollin e 13, të vitit '86, është hequr dënimi me vdekje në shtetet nënshkruese të Konventës të Këshillit të Evropës. Kjo nënkupton që në asnjë rast, dënimi

me vdekje, ne nuk mundemi ta ekstradojmë. Kjo ndodh edhe e kundërta ose ka pasur raste kur njerëzit tonë, në vitet e 80-ta nuk janë ekstraduar nga shtetet demokratike në ish-Jugosllavi, për shkak që veprat e tilla nuk kanë qenë të parapara në ato shtete ku janë.

Sa i përket rastit të zotit Shemsi Nuhiu, nëse më lejohet ta them, Ministria e Drejtësisë dhe ambasada jonë në Zvicër kanë marrë të gjitha masat që ai të mos ekstradohet në shtetin e Serbisë, por të ekstradohet dhe të zhvillohen procedurat në shtetin e Kosovës.

Sa i përket deklaratës financiare, ne e kemi marrë në Ministrinë e Financave, deputete Hadergjona dhe, sipas saj, e kemi proceduar në Kuvend, por në cilindo rast, janë mjete të përballeshme buxhetore që Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë do t'i gjejë për implementimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër edhe zëvendëskryeministër!

Në sallë ka 77 deputetë. I ftoj deputetët dhe regjinë të bëhemi gati për votimin e Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, në parim.

Votojmë, tash.

Konstatoj se me 77 vota “për”, 0 “kundër”, 0 abstenim, miratohet në leximin e parë Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Ramë Buja, i cili nuk është këtu, por unë, sa po marrë vesh, zoti ministri Bajram Rexhepi do ta paraqesë dhe do ta arsyetojë projektligjin. A është kështu zotëri?

Ministri Rexhepi e ka fjalën.

BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Më ka ndihmuar ministri Ramë Buja me prezantimin e Projektligjit për arsimin parauniversitar, aq më parë them për arsye se materialin që ma kanë dërguar, nuk është ekspozë, po është një memorandum shpjegues dhe tash duhet të bëjë pak edhe improvizime t’i nxjerrë disa pikë kryesore në këtë memorandum shpjegues, që mos t’ju marrë shumë kohë, por duke qenë i bindur se projektligji është përgatitur mirë, dhe pastaj nëpër komisionet funksionale, ju do t’i jepni kontributet e juaja me amendamente dhe kjo ekspozë që nuk është e përgatitur mirë, nuk do ta dëmtojë

ligjin e ardhshëm, kështu që kërkoj falje paraprakisht për arsye se ekspozenë nuk e kam para jush.

Arsyeja kryesore pse është ky projektligj para jush, është se për arsimin parauniversitar edhe më herët ka pasur ligje, por që janë treguar jofunksionale deri tani dhe po ashtu ka pasur ndryshime edhe në statusin juridik dhe politik të Kosovës. Pra, në ndërkohë Kosova e ka pavarësinë e vet, e ka Kushtetutën e vet, ndërkohë, kemi edhe zhvillime tjera, si obligimet që dalin nga pakoja e Ahtisarit. Është me rëndësi që ky projektligj është një prej kushteve, po ashtu të Raportit të Progresit, dhe çështja e financimit nëpër shkolla e tjerë, kanë pësuar disa ndryshime. Prandaj, me të gjitha këto ndryshime në këtë projektligj, ka qenë e domosdoshme që të prezantohet një projektligj i ri dhe amendamenti i ligjeve të mëparshme.

Pra nxjerrja e këtij projektligji, arsyetohet me mungesën e funksionalitetit të ligjit paraprak dhe vështirësitë në zbatimin e tij, harmonizimin e ligjit me dispozitat kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe eliminimin e të gjitha zbrazësive nga ligji i mëparshëm.

Reformat e Projektligjit.

Me këtë projektligj bëhen ndryshime në sistemin arsimor të Kosovës, me ligjin paraprak. Pra, në vend se nga zero deri në nivelin tre, me këtë projektligj parashihen nivelet 0, 1, 2, 3 dhe 4. Niveli 1 me ligjin paraprak, ka qenë prej moshës 3 deri në moshën 6 vjeçare, ndërsa me këtë ligj, prej moshës 0 deri në 6 vjet.

Në klasa parafilllore fëmijët mbi moshën 5 vjeçare janë inkorporuar në shkollimin e detyruar. Me këtë ligj parashihet niveli i katërt, që përfshin arsimin terciar në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional në periudhën 1 vjeçare deri në 2 vjet.

Me këtë ligj, parashihet korniza e kurrikulumit të Kosovës si dhe formimi i Agjencionit të Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim. Sistemi financiar, ku komuna delegon përgjegjësitë për buxhet dhe financa tek institucionet arsimore, monitorimi me këtë ligj, parashihet Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, mbrojtja nga sanksionet arbitrare, personeli profesional, jo mësimdhënës për ofrimin e shërbimeve profesionale siç janë: kujdesi mjekësor, mbështetja pedagogjike, psikologjike si dhe punë këshilluese dhe sociale.

Vlerësimi profesional nga ekipi profesional, i formuar nga komunat, institucionet arsimore dhe aftësuese, të partneritetit, Ministria dhe komuna me individë ose institucion, licencimi dhe inspektimi i shkollave private, dhe atyre me partneritet, shkollim-shtëpi.

Çështjet e adresuara, si thashë janë plotësimet dhe harmonizimet me pakot ligjore tjera dhe pakon e Ahtisarit dhe që të mos ju marrë shumë kohë, ky projektligj është në harmoni me ligjet e ngjashme në Bashkimin Evropian, implikime financiare janë, mirëpo është edhe deklarata financiare për këtë projektligj. Dhe, në fund edhe një herë duke ju kërkuar falje për këtë ekspozë jo më të mirën, që në fund të fundit nuk është

faji im, po megjithatë pres që projektligji është i përgatitur mirë dhe kjo ekspozitë nuk do të ndikojë në cilësinë e projektligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Jo, por ti na preke me përkushtimin tënd. Ju lutem shumë. Në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Media e tjera, fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kriteret e parapara, nenin 54 të Rregullores së Kuvendit, prandaj i rekomandon Kuvendit që ta miratojë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Vehapi!

Në emër të grupeve parlamentare ose shefat e grupeve.

Për Grupin e PDK-së, deputeti Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe jep mendimin se ky ligj është i thurur mirë, është i kuptueshëm gjuhësisht dhe përmbledh në mënyrë të plotë të gjitha aspektet e rregullimit të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Për dallim prej ligjit të mëparshëm, ky ligj ka përfshirë disa risi, pra janë të rregulluara brenda këtij ligji: themelimi dhe funksionimi i Këshillit Shtetëror për Arsim Parauniversitar, Këshilli Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve, Inspekcioni i Arsimit, Këshilli i Prindërve të Kosovës, Agjencioni i Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim. Pra, është mirë i rregulluar procesi i licencimit të mësimdhënësve, funksioni i organeve drejtuese të shkollës, është bërë harmonizimi me ligjet që definojnë arsimin nëpër komuna, pra kompetencat që i ka Ministria dhe komunat në fushën e arsimit parauniversitar.

Ne mendojmë se janë dhe disa gjëra që mund të rregullohen me mirë me këtë ligj. Për shembull nuk është qartë i definuar niveli 4 i arsimit, nuk janë të sanksionuar me ligj organizimi dhe objektivat e testit të arritshmërisë pas klasës së 6-të dhe të 9-të. Po ashtu nuk janë sanksionuar dënimet për prindërit që ndalojnë fëmijët nga shkollimi i detyruar, dhe disa tjera që ne do t'i shqyrtojmë në Komisionin për Arsim.

Pra, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e përkrah këtë projektligj, dhe ne do t'i japim kontributin tonë të pakursyer nëpër komisionet përkatëse, ndërsa mirëpresim edhe kontributin e kolegëve tjerë që me vërejtjen dhe sugjerimet e tyre, e bëjnë që ky ligj të jetë sa më i kompletuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Vataj!

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, flet profesor Eqrem Kryeziu, deputet natyrisht.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti nënkryetar! Më lejoni, ju lutem, që t'i përsëndes tre ministrat e pranishëm këtu, natyrisht edhe të gjithë kolegët dhe koleget në Parlament.

Unë isha shumë i ngazëllyer me faktin se mu besua, si të them, obligimi që ta mbroj në Parlament këtë projektligj, por kisha pasur njëfarë lloj lajthitjeje, se unë mendova se është Projektligji për shkollimin parashkollor, që mua më përshtatet më lehtë, do të thotë, për kah konceptimi, e kuptoj më mirë, por ky sidoqoftë është parauniversitar edhe unë detyrohem të them se edhe grupi ynë është i kënaqur, sepse dispozitat e këtij ligji janë në pajtim me ISCED, do të thotë standardet ndërkombëtare të klasifikimit të arsimit. Veçanërisht do të thoshim se është inkurajues edhe neni ku përfshin dispozitat për arsimim dhe aftësim të të rriturve.

Të them të drejtën, në kohën kur mundohemi që të mos kemi diskriminim, ne nuk e bëjmë shumë dallimin ndërmjet atyre që kanë shkollë dhe atyre që nuk kanë shkollë. Kjo do të duhej të ishte sepse, siç e keni vërejtur, shpresoj zoti kryesues, ata që s' kanë shkollë janë shumë të bindur se kanë gjithmonë të drejtë dhe, në qoftë se sidomos gjenden në pushtet, atëherë kris kiameti, do të thotë. Kështu që këto dispozita për shkollimin e të rriturve, unë besoj se do të vlejnë më së pari edhe për stafin qeveritar të cilësdo qeverie qofshin, madje edhe të kësaj, që le të shkollohen dhe le të dresohen pak a shumë, se nuk janë, si të them, pronarë të së vërtetës absolute, se kështu sillen ata njerëz, në këtë formë. Kështu që më mban uzdaja e madhe që do të prodhojë ky ligj edhe efekte të tilla shumë të mira dhe premtuese për perspektivën e Kosovës. Në qoftë se ka të tillë, natyrisht unë s' po akuzoj dhe me shkollim nënkuptoj shkollim të mirëfilltë, jo me qofte t'i marrin diplomat ose t'i marrin fals.

Ajo që do të dëshiroja gjithashtu, nuk di a do të guxoj ta them edhe në emër të Grupit, por besoj se do të më përfshijnë këtë në gjirin e grupit të tyre, është njëfarë shqetësimi imi se në fakt në dispozitat kalimtare, ky projektligj, ka dy herë, dyfish double hipotetik. Do të thotë, ligji mund të zbatohet në vitin 2015, në qoftë se mund të sigurohen mjetet. Unë do të isha shumë i lutur, besoj se edhe të tjerët, që praktikisht, të paktën, njëra nga hipotetikat të hiqet.

Ne, sidoqoftë po themi që jemi të inkurajuar me faktin se ka do standardizime të mira me këtë projektligj, veçanërisht kur figuron dispozita që ndalohet ndëshkimi edhe poshtërimi i nxënësve në shkollë, kjo është një punë e madhe. Ishalla nuk e rrok ky nen edhe Parlamentin, se do të duhej të përjashtoheshim shumica prej nesh. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Eqrem, për sharmin edhe sendet tera, por ky është për parauniversitar, ndoshta nëpër institucione, pa shkollë të mesme nuk ka njerëz, që po thua ti.

Ne emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për arsimin parauniversitar dhe si e tillë, në parim e përkrah këtë projektligj, megjithatë kjo lëvizje ka disa vërejtje serioze ndaj këtij projektligji dhe si e tillë shpreson se këto vërejtje do të merren në konsideratë në fazat më tutjeshme të procedimit të projektligjit për arsimin parauniversitar.

Pra, nëse shikohet me vëmendje ky projektligj, shpeshherë përmban kontradiktën ndërmjet pjesëve përbërëse të tij, çfarë dhe rrjedhimisht e bëjnë atë paradoksal, konfuze dhe të paqartë në disa çështje themelore. Këto gabime kanë të bëjnë që nga çështjet më të lehta, sikurse përkufizimi që përmban neni 2, pika 1. 33, se nxënës nënkupton çdo person të regjistruar në çfarëdo programi të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore dhe aftësuese, të financuara nga fondet publike, duke mos dhënë përkufizim tjetër se çka na qenkan ata që vijojnë mësimet në institucionet arsimore private e që nuk janë të financuara nga fondet publike.

Po ashtu, duke ju referuar vetë përkufizimeve dhe terminologjisë që është përdorur në këtë projektligj, të krijohet përshtypja sikur ky projektligj është sajuar vetëm për të mbrojtur vlerat dhe normativizuar të drejtat konkrete të komuniteteve dhe në anën tjetër, për të dhënë një përkufizim abstrakt dhe pa përmbajtje, sa i përket vlerave historike dhe kulturore të shumicës.

Kështu për shembull, duke arsyetuar qëllimet e ligjit, neni 1, pika 2.4 thotë se qëllimi i këtij ligji është zhvillimi i respektit të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e komuniteti të tij dhe duke vazhduar më tej me nenin 3, pika 5.2, se me këtë ligj kultivojmë njohuritë për kulturën, historinë dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve, por çka thotë neni 2, pika 1.8? Thotë se komunitet është një grup kombëtar etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, që tradicionalisht është i pranishëm në Republikën e Kosovës dhe që nuk është shumicë. Pra kjo i bie që ky projektligj dëshiron që t’i thellojë njohuritë e vetëm për ato grupe dhe apo komunitete si quhen ndryshe që janë pakicë. Konsiderojmë se duke u bazuar në këto dispozita ligjore, qëllime dhe formulime të tilla, jo vetëm që janë skandaloze përmbajtësisht, por edhe të rrezikshme për shoqërinë tonë sa i përket realizimit praktik.

Projektligji në fjalë, po ashtu përmban edhe disa kontradikta tjera të cilat bëjnë që neni të dinë të bien në kundërshtim të hapur ndërmjet veti, me këtë rast bie fjala, neni 5, pika 1.3, thotë se detyrat e Ministrisë janë që të promovoj sistem jo diskriminues të arsimit, me të cilin respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësitë e barabarta - theksoj për arsim cilësor. Por neni 28 pika 3. 7, thotë se nxënësit që i takojnë komuniteteve, kanë peshë më të madhe. Kështu këto dispozita mendoj se ndodhin në kontradikta me njëra tjetrën, sepse nuk është e mundur që në të njëjtën kohë të ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit dhe po ashtu

nxënësit e komuniteteve të kenë peshë më të madhe se ato të shumicës, atëherë Ministria duhet të na shpjegoj se çfarë është pesha e tyre, është akademike, intelektuale, që ne nuk kemi arritur ta kuptojmë.

Në disa aspekte tjera, konfuzioni dhe ambikuiteti rriten edhe më tej, siç është rasti me nenin 17, pika 5, i cili thotë se për vijim ose për të zvogëluar braktisjen e shkollës, komuna organizon transport të sigurt dhe efikas për nxënësit në shkollim të detyruar. Thotë komuna mund të kërkojë pagesë, por edhe mund ta bëjë falas transportin shkollor. Komuna për shkollim të detyruar konsideroj se duhet ta sqarojë dhe të jetë e prerë në këtë vendim ose do të kërkojë pagesë ose do ta bëjë falas transportin e tyre.

Sidoqoftë, ajo që vlen të merret si me problematike, ka të bëjë edhe me faktin se ky ligj në momente të caktuara e shndërron ministrin në arbitër përfundimtar edhe me çështjet që kanë të bëjnë me sferën kushtetuese, ligjore dhe juridike të Kosovës. Bie fjala, neni 22, pika 3 thotë: se, nëse prindi është i pakënaqur me vendimet e komunës, ai mund të ankohet te kryetari i komunës dhe, nëse prindi është i pakënaqur edhe me vendimin e kryetarit të komunës, ai mund të dorëzojë në Ministri një ankesë në lidhje me mosrespektimin e Kushtetutës apo ligjit në fuqi. Vendimi i ministrit, theksoj thotë do të jetë përfundimtar.

Konsiderojmë se ky konstatim qëndron në shpërputhje me standardet ligjore të një shteti demokratik, sepse ministri është autoritet politik dhe nuk është autoritet juridik që e bënë interpretimin përfundimtar të ligjeve, çështjeve kushtetuese.

Edhe sa i përket dimensionit akademik, ligji në disa momente është joserioz, për shembull neni 4, pika 3 thotë: “se kur çështjet relevante të paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësve duhet t’u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta”. Konsiderojmë se në çështjet arsimore nuk bënë të ekstrapulohet logjika e luftës politike ku ndërmjet pikëpamjeve ekstreme, duhet të kërkojë kompromisi, por nxënësit ndërmjet pikëpamjeve të kundërta, duhet stimuluar dhe kërkojnë atë pikëpamje që përfaqëson të vërtetën shkencore dhe arsimore, por ajo, nëse në pikëpamje është e vërtetë dhe tjetra rrenë, hajt pak prej kësaj, të marrim edhe prej kësaj dhe ta krijojmë nj mish –mashë, domethënë kjo është e papranueshme.

Dhe në fund, shumë nga dispozitat e këtij projektligji, madje mbetet e paqartë se a do të mund të zbatohen, sepse neni 49, lidhur me dispozitat kalimtare thotë se ato mund të hyjnë në fuqi që nga viti shkollor 2015-2016 po qe se krijohen kushtet financiare. Kjo i bie, që në rast të deficiteve buxhetore dhe financiare për vitet në vijim, ato dispozita ndoshta edhe nuk do të mund të implementohen, çfarë kjo do të prodhonte probleme edhe më të mëdha në sferën e arsimit, dhe në të vërtetë ky ligj në vend se t’i zgjidhte ato, do të thellonte edhe më tej konfuzionin dhe kaosin në këtë sferë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Ne emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kymete Bajraktari. Po, a je paraqitur? Teuta Haxhiu, në emër të Aleancës. Është mirë për të kallëzuar më herët.

TEUTA HAXHIU: Dy herë, se jo një herë, me gjithë dorë të ngritur, me shkrim nuk po mundem, do të flet, normal, se do të flet edhe kolegja ime.

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndonëse projektligji në masë të konsiderueshme i përmbush kriteret për miratimin e tij, ne si Grup Parlamentar i Aleancës, do ta votojmë në parim, mirëpo mbetet akoma shumë për t'u diskutuar dhe përmirësuar në disa nene të tij.

Unë do të mundohem t'i përmend disa.

Neni 1, pika 2.4, ku thuhet: “zhvillimi i respektit të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit” për identifikimin kulturor, gjuhën dhe vlerat e komunitetit të tij, për vlerat e Republikës së Kosovës për shtetin nga i cili mund të ketë prejardhjen dhe për qytetërimi që dallojnë nga ai, i tij, ne mendojmë se këtu sikur i është ikur anës kombëtare, prandaj në këtë rast prejardhja mund të keqinterpretohet.

Pastaj, neni 1, pika 2.6 ku thuhet se: “të zhvillojë te nxënësi respektim për mjedisin”, mendojmë se duhet t'i shtohet edhe fjala: “ndjenjën ” pra të zhvillojë te nxënësi ndjenjën dhe respektin për mjedisin.

Në nenin 1, pika 3, thuhet më sa vijon: “asnjë dispozitë e këtij ligji, nuk do të interpretohet si zvogëlim apo kufizim i çfarëdo të drejte të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të paraparë me ligjin në fuqi. Mendojmë se ky nen është nen hipotetik, pse të lihet hapësirë për aludim se mund të zvogëlohet të drejtat e komuniteteve.

Neni 2, pika 1.5, thuhet: “vlerësim i referohet proceseve, përfshirë provimet dhe testet, që përdoren për të grumbulluar, analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e arritjes individuale në mësim, duhet të jetë “e arritjeve individuale në arsim”.

Në nenin 2, pika 1.37, është shkruar: “vit shkollor” do të thotë perioda fillon nga muaji shtator”, duhet të saktësohet mendojmë edhe data se kur, do të thotë se muaji shtator fillon dhe nuk e ka një ditë të caktuar.

Në nenin 2, pika 1.38 thuhet: “standardet janë tregues”, standardi është përcaktues i një rregulli mendojmë ne. Këtu duhet të riformulohet.

Në vazhdim në nenin 3, pika 6, qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar, do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim, në baza ekzistuese ose supozuara siç është ai gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësisë fizike e tjerë, kështu ndoshta do të duhet të sqarohet se çka nënkuptohet me orientimi seksual, në mos aludohet në homoseksualizëm.

Pastaj, te neni 3, pika 7, institucionet publike arsimore, duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagandojnë një fe të caktuar. Ne mendojmë që këtu duhet t'i shtohet edhe pasusi: “dhe nxisin urrejtje ndër fetare”, ndërkaq te neni 5, pika 1.2, është shkruar: “të përcaktojë rezultatet e niveleve të

ndryshme”. Ne mendojmë se këtu duhet të jetë: “ të përcaktojë kërkesat për rezultatet e niveleve të ndryshme” ose të vazhdoj më tutje.

Në vazhdim të neni 5, pika 3.1, thuhet: dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet e arsimit, si dhe nga ato të aftësimit nuk duhet të përmbajnë të dhëna personale përveç emrit. Ne mendojmë se duhet të jetë emri, emri i babës dhe mbiemri, sepse vetëm me emër dhe me ditëlindje nuk janë, besoj të përcaktuara plotësisht ashtu siç duhet.

Në vazhdim, të neni 7, pika 3.4, thuhet: përmes bashkëpunimit me prindër, polici dhe autoritete tjera publike, marrin hapa për të adresuar sjellje të dhunshme dhe keqpërdorimin, në ose në lidhje me institucionin përkatës. Sigurimi i kuadrit pedagogjik, këtu kemi pikëpyetje të mëdha në kompetencë dhe të kujt do të duhej të ishte.

Të neni 8, pika 4.5 është shkruar: zbatimin e kornizës kombëtare të kurrikulumit, duke përfshirë kurrikulimin në bërthamë, kurrikulumin me bazë shkolle, procedurat e testimit dhe vlerësimit, përdorimin e teksteve të miratuara, nuk ceket nga kusht të miratuara, do të duhej të ishte nga MASHT-i.

Të neni 8, të pika 6.2, kemi të shkruar: Ministria mund të udhëzojë komunën që të ndërpres marrëdhënien e punës të një mësimdhënësi që është punësuar në kundërshtim me kriteret e specifikuar në këtë ligj ose është përjashtuar nga puna për shkak të kushteve mjekësore ose urdhrit të gjykatës apo dispozitat e tij ose ligjeve tjera në fuqi. Kërkojmë që një gjë e tillë, do të duhej do të thotë, të shtohet edhe kjo “apo ka bërë shkelje ligjore të rregullave të punës”.

Të neni 8, pika 6.3, thuhet: “Në rast se vërehen mangësi të zbatimit të kurrikulumit, për ke është fjala do të duhej të ceket, a është fjala për nxënësit apo mësimdhënësit, Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimi shtesë ose alternativ? Pra të specifikohet se për ke është fjala.

Të neni 22, pika 5, thuhet: “Komuna mund të udhëzojë drejtorin e shkollës apo Këshillin drejtues të shkollës, në rastet kur, sipas mendimit të komunës, edukimi, arsimit apo siguria në shkollë, është ose mund të dëmtohet në një të ardhme të afërt nga veprimtaritë e nxënësve apo prindërve”. Këtu vlerësojmë se kërkohet një nen që i përcakton përgjegjësitë e prindit për veprimet e nxënësit, dëmet e shkaktuara që mund t'i bëjë fëmija i tij apo të bartet tek pjesa, prind.

Ndërkaq neni 27, pika 1, tekstet shkollore dhe materiale të tjera në gjuhën serbe, për nivelin 1-2, do të përdoren siç është përcaktuar me ligjin në fuqi dhe jepen falas.

Të neni 28, pika 3.7, standardet e reja të përcaktuara nga Ministria, ndërsa nxënësit që u takojnë komuniteteve, kanë pjesë më të madhe. Konsiderojmë se shprehja nxënësit që u takojnë komuniteteve, kanë peshë më të madhe, është diskriminuese për shumicën.

Te neni 29, pika 3.6, thuhet: “nuk mund të tejkalohet pjesa e miratuar e buxhetit për një institucion arsimor apo aftësues”, duhet të formulohet një përcaktim, viti fiskal të përshtatet me vitin shkollor për çështjet e pagave dhe të tjera.

Te neni 31, pika 31, thuhet: “Mësimdhënësit shërbyes profesional publik që kryejnë detyrën në institucionet arsimore dhe aftësues sipas legjislacionit në fuqi dhe të cilët përmbushin kushtet e nevojshme të parapara me këtë ligj”. Mënyra dhe kushtet e punësimit, Ministria i përcakton me normativë përparësitë për punësim.

Te neni 35, zgjedhja ose emërimi i drejtorëve dhe i zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentë dhe instruktorë, shprehja “instruktor” duhet të futet si subjekt, duke e precizuar rolin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Haxhiu,!

Ne emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, po besoj Jeton Svirca.

Ju kur jeni edhe po ju sugjeroj, mos kujtoni që e di unë cili e ka shenjën që flet, unë e di se Ardian Gjini e di që është shef, por ju të tjerët, për mua jeni njësoj. Nëse jeni tre, pa më treguar, unë nuk e di cili është. Tash Jeton Svirca, a është për...? Hajt, urdhëro!

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tani jemi duke e bërë leximin e parë të Projektligjit për arsimin parauniversitar, qëllimi i të cilit është që të rregullojë edukimin, arsimimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që kanë marrë kualifikime në këto nivele.

Duke e përshëndetur paraqitjen e këtij projektligji për miratim në Kuvendin Kosovës, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, njëkohësisht ka edhe disa vërejtje serioze që kanë të bëjnë me nenet 2; 3.7, 4.3, 5.3, 22.3, 23.2, 28.3, 28.7, 33.8, 34.4 dhe neni 34.5.

Vërejtje e përgjithshme është se projektligji ekskluzivisht merret me çështje të arsimit dhe ngritjes profesionale, ndërkaq komponenti edukativ është dukshëm i lënë anash. Si ilustrim, fjala edukim përmendet vetëm 4 herë në tërë tekstin ligjor, që konsiderojmë se është e papranueshme, duke e pasur parasysh dukuritë e shumta negative, në mesin e rinisë shkollore si rezultat i mungesës së komponentit edukativ në procesin mësimor.

Përfshirja e të rinjve nën moshën 18 vjeçare në vepra kriminale, është në rritje e sipër. Statistikat tregojnë se të miturit në Kosovë, gjatë një periudhe 12 muajsh, korrik 2006, qershor 2007, kishin kryer më se 4.723 vepra penale. Hulumtimi i nëntë i Kombeve të Bashkuara mbi trendët e krimit 2003-2004, tregon se shkalla e krimeve të kryera nga të miturit në Kosovë, është dukshëm më e lartë se ajo e shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Ndërsa, në një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit, për vitin 2009,

thuhet se në Kosovë ka më se 20.000 veta që përdorin drogën. Përdoruesit kryesisht janë studentë dhe fëmijë të moshës adoleshente.

Një dukuri tjetër e shëmtuar që është prezent në Kosovë, në Kosovën e pasluftë, është rritja e numrit të vajzave që abortojnë në moshën e re 15 deri në 26 vjeçare.

Në periudhën pasluftës jemi dëshmitarë të shtimit dramatik të numrit të tentimeve të vrasjeve dhe të vetëvrasjeve në Kosovë. Veçanërisht ..

KRYESUESI: Je jashtë teme, totalisht! Po kujtoj që ti po dëshiron të arsyetosh diçka, por kthehu në ligj, të lutem shumë! Po, kthehu në ligj, ti po do edukim, po të kuptoj, por kthehu në ligj.

JETON SVIRCA: Po, unë jam aty duke dal edhe e kam një arsyetim të shkurtër edhe do të dal aty te prezantimi...

KRYESUESI: Po duke dalë, por ti nuk je në temë, ti po flet për, por nuk je zotëri, kthehu në ligj, po të them!

JETON SVIRCA: Njëri prej faktorëve, në mesin e shumë të tjerëve të cilët drejtpërdrejt ndikojnë në paraqitjen e kësaj dukurie shqetësuese është humbja e stabilitetit psikologjik, të rinjve si rezultat i krizës së thellë të familjeve tona të cilat të ballafaquara me rrethanat e krizës ekzistenciale, nuk po arrijnë të ushtrojnë edhe rolin e domosdoshëm edukativ për fëmijë.

Në situatën kur veprimtaria edukative heq dorë edhe sistemi publik parashkollor, atëherë është e qartë se rinia jonë i është lënë edukimit, kaotik që ushtrohet nëpërmjet internetit dhe kafiterive. Pasojat janë të qarta, dhuna në shkollat tona, nga dita në ditë është në rritje, deri kur do t'i mbyllim sytë para këtij realiteti të vrazhdë? Deri kur do të lejojmë që nxënësit tonë të vriten dhe të lëndohen në objektet shkollore?

Grupi Parlamentar për Kosovë të Re, konsideron se ka ardhur koha që ky trend shkatërrimtar të ndërpritet nëpërmjet fuqizimit të rolit edukativ, të shkollave tona në nivel parauniversitar nëpërmjet zbatimit të lëndës të edukatës fetare në sistemin publik, arsimor parauniversitar. Argumente se zbatimi i mësimi fetar në shkolla, nuk është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që e përcaktojnë Kosovën si shtet laik sekular, është plotësisht i pa qëndrueshëm. Parimi i ndarjes së institucioneve fetare nga proceset e vendimmarrjes shtetërore, i cili qëndron në themelet e konceptit kushtetues të laicitetit ose sekularitetit të shtetit, nuk ka të bëjë asgjë me çështjen e zbatimit të lëndës së edukatës fetare në shkollat publike, sepse për këtë çështje në mënyrë ekskluzive dhe përfundimtare vendosin vetë institucionet shtetërore. Sikur këto prime të ishin të argumentuara, atëherë si mund të shpjegohet fakti i zbatimit të lëndës së edukatës fetare në Gjermani, Austri, Belgjikë, Itali, Britani të Madhe dhe shumë shtete tjera të Bashkësisë Evropiane, si lëndë obliguese ose zgjedhore, a thua këto shtete nuk janë shtete sekulare apo laike si Kosova. Pra, zbatimi i lëndës së edukatës fetare në shkolla është

praktikë e gjerë e zbatuar në Shtetet e Bashkësisë Evropiane dhe në asnjë mënyrë nuk është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

Me këtë rast, Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re përkrah parimin se zbatimit të edukatës fetare në shkolla. Duhet siguruar edhe njohuri themelore për të gjitha religjionet relevante, përveç atij për të cilin përcaktohen nxënësi dhe prindi i tij në mënyrë vullnetare.

Koalicioni për Kosovë të Re insiston që kjo çështje të zgjidhet ekskluzivisht në pajtim me praktikat më të mira të Shteteve të Bashkësisë Evropiane, ku synojmë të integrohemi në sistemin autokton të vlerave tona kombëtare dhe kulturore.

Përkitazi me këtë, Grupi Parlamentar për Kosovë të Re thekson nevojën për ndryshimin ose largimin e nenit 3.7 të Projektligjit dhe plotësimin e Projektligjit me 3 nene të reja, duke paralajmëruar amendamente konkrete në këtë drejtim.

Këto amendamente do të bazohen në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konkretisht në nenet 3.2, 7.1, 8, 16.1, 16.3, 19.2, 21.1, 21.3, 22, 23, 24, 38.2, 38.3, 47.2, 54, 55.5, 56.2, si dhe deklaratat e universale mbi të drejtat e njeriut e vitit 1948, Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale e vitit 1950, Udhëzuesin e OSBE-së për mësimdhënien e fesë dhe besimeve në shkolla publike dhe Ligjin për të drejtat dhe liritë fetare, si dhe shumë konventa tjera relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat afirmojnë dhe garantojnë të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, besimit dhe fesë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e personave për të manifestuar fenë e tyre në mënyrë të ndryshme, duke përfshirë edhe atë përmes mësimi.

Bazuar në këto të drejta themelore të njeriut dhe të fëmijës për liri të fesë dhe të besimit gjatë procesit arsimor, në një varg shtetesh lënda fetare zbatohet si një prej lëndëve mësimore në shkollat publike, pra siç e cekëm më herët në Gjermani, Austri, Izrael, Britani të Madhe, Spanjë, Belgjikë, Irlandë, Finlandë, Danimarkë, Norvegji, Hungari, Poloni, Itali, Slloveni, Kroaci, ku i kemi edhe materialet që i kemi marrë nga këto shtete, të gjitha i kemi, si dhe Bosnja e Hercegovina e tjera.

Përvojat e rëndësishme pozitive përkitazi me zbatimin e lëndës së edukatës fetare në sistemin publik të arsimit mund të shihen edhe në shkollat e Luginës së Preshevës, ku lënda fetare zbatohet me vite të tëra si lëndë fakultative me vijueshmëri të lartë mbi 85%, pa asnjë problem.

Për fund, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re apelon te të gjitha grupet parlamentare që të përkrahin amendamentet të cilat Grupi ynë do t'i propozojë në komisionin funksional dhe që me këtë të ndihmojë rininë tonë që në shkollat tona publike të pajiset me edukatë të shëndoshë, e cila do t'u ndihmojë të ballafaqohen me më shumë sukses, me sfida të mëdha të realitetit jo të volitshëm ekonomik dhe social që i rrethon.

Jemi të bindur se në këtë mënyrë do të eliminohen edhe shkaqet tjera, dukuritë tjera shkatërrimtare për shtetin e Kosovës, si prostitucioni, trafikimi i njerëzve, narkomania,

huliganizmi në shkolla, alkoolizmi, vetëvrasjet e deri te korrupsioni institucional, si shprehje kulminante e rrënimit të shëndetit etik dhe moral të një shoqërie.

Largimin e lëndës së edukatës fetare nga shkollat publike e ka bërë regjimi komunist dhe ka ardhur koha e fundit që edhe në këtë aspekt të shënojmë ndarje në këtë ideologji dhe sistem shkatërrimtar për qenien tonë kombëtare dhe shtetërore.

Të nderuar deputetë, mësimi i fesë në kuadër të sistemit të arsimit ka edhe një komponentë shumë të rëndësishme për momentin aktual politik të vendit tonë, e kjo është mundësia e indoktrinimit të nxënësve tonë me ideologji të huaja, që nuk ka pasur në traditën e familjeve tona, duke hapur rrugë për forma të ndryshme të manifestimeve dhe organizimeve ekstreme fetare që nuk përkasin me realitetin e fesë.

Në kërkesën për zbatimin e lëndës së edukatës fetare në sistemin publik të arsimit në asnjë mënyrë nuk duam që nga sistemi publik i arsimit të nxirren klerikë fetarë, por duam që nxënësit tanë, bijtë dhe bijat tona të mësojnë parimet themelore etike dhe morale që burojnë nga besimi në Zotin e madhërishëm, që paraqet njërën prej vlerave më të mëdha të qytetërimit tonë.

Lënda e edukatës fetare, në kurrikulumet e shkollave publike duhet të shihej si mënyrë e shkëlqyer për themelimin e harmonisë, të paqes, të tolerancës dhe të zhvillimit ekonomik, si dhe duhet të realizohet në mënyrë të drejtë, duke zvogëluar në minimum mundësinë e indoktrinimit dogmatik të nxënësve.

Ju ftojme që ta zgjedhim këtë në formën më të mirë të mundshme pa e politizuar, pa e polarizuar, pa e paragjykuar, por në qetësi, profesionalizëm, eksperiencë ta kryejmë detyrën tonë. Nuk shoh asnjë arsye që dikush të ketë frikë nga mësimi i fesë në kuadër të sistemit publik, sepse sa më të arsimuar që të jemi, aq më të kulturuar, aq më të integruar, aq më tolerantë, aq më objektivë, aq më të dashur e më të respektuar do të jemi.

Të nderuar deputetë, nuk po kërkojmë asgjë më shumë se praktikat më të mira evropiane përkitazi me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të SLS a është paraqitur dikush? Nuk është paraqitur. Në emër të “6+” Enis Kervan, nënkryetar i Kuvendit!

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Kanunun 2. Maddesinin tanımlar bölümünde,

1.29 sayılı paragrafta “resmi olmayan diller” terimini, tamamen yasa boyunca değiştirilmesi gerekmektedir Birincisi bu fıkra ve diğer yasa maddeleri, Kosova’da konuşulan dilleri değil, eğitim dillerini ve sistemini düzenlemektedir. İkincisi bir husus ta, “resmi olmayan diller” denilerek ifade edilmeye çalışılan dillerden söz edilirken, Kosova Anayasasına göre yerel düzeyde bunun tam tersi resmi diller anlamını

taşımaktadır ve merkezi kurumlarda, mesela Kosova Meclisi, Kosova anayasa Mahkemesi v.s gibi resmi kurumlarda resmi dillerle birlikte Türkçe de kullanılmaktadır.

Üçüncü bir husus da, ister Kosova Cumhuriyeti Anayasası, ister diller yasası, ister de topluluklar yasasında “resmi olmayan diller” şeklinde ne herhangi bir terimden söz edilmekte, ne de böyle bir tanım mevcuttur.

Dolayısıyla bu fıkra ve yasanın tüm diğer maddelerinde “resmi olmayan diller” terimi yerine “topluluk dilleri“ terimi, “konuşulan diller” terimi yerine de “yerel düzeydeki resmi diller ve topluluk dilleri” terimi yer almalıdır.

Kanunun 3.7 maddesinin tamamen kaldırılması gerekmektedir. Böylece dini derse olanak sağlanılacaktır. Çünkü bu maddenin söz konusu fıkrası “kamu eğitimi kurumlarını, dini eğitimden ve belli bir dine ait aktivitelerden kaçınmaları gerektiğini” belirtmektedir.

Bu fıkranın bu şekilde kalması, ister zorunlu ders ister seçmeli ders olarak okullarda “din dersinin” müfredat plan ve programlara eklemesini engellemekle birlikte, asıl bu durumda halkta büyük bir huzursuzluk yaratması olasıdır. Oysa bu maddenin olduğu gibi kaldırılmasıyla herhangi bir kısıtlamaya veya engele gidilmeyecektir, bakanlık bu konula alt yasa akitleriyle ve yönetmenlikleriyle daha rahat bir şekilde düzenleyecek ve çoğunlukta olan halkın düşüncesini de tatmin edecek, saygı duyacaktır.

Kanunun 5. maddesinde topluluklara yönelik sınıfların açılması da belirtilmelidir. Topluluk şartlarının göz önünde bulundurulmasıyla birlikte, daha az öğrenci sayısı da sınıflarının oluşturulması olanağı göz önünde bulundurularak, bu husus tamamıyla garanti altına alınmalı ve değiştirilmelidir. “

Kanunun 5. maddesinin 3.2 fıkrasına göre, tüm evraklar resmi diller üzere sunulmaktadır, denilmektedir. Resmi olmayan dillerde eğitimini tamamlayan öğrencilere ait tüm evraklar, resmi diller yanı sıra kendilerinin eğitim gördükleri diller üzere kayıt edilmeli ve verilmelidir. Üniversite öncesi eğitimin tüm aşamalarda, belediye düzeyindeki kurumlarda gerçekleştirildiğini göz önünde bulundurarak, bu maddeye ait fıkroda; Resmi dillere ek olarak topluluk dilleriyle birlikte “belediyedeki resmi diller” fıkrası yerini almalı, öğrencilere sunulan tüm evraklar, söz konusu belediyelerde kullanılan tüm resmi dillerde ve resmi kullanımdaki dillere göre sunulması gerektiği belirtilmelidir.

Yasanın 6.maddesi, Üniversite Öncesi Devlet Konseyi’nin oluşumunu düzenlemektedir. Bu maddeye göre Devlet Konseyi 9 üyeden oluşmalıdır, uzman üyelerin sekizi Kosova kurumları tarafından önerilirken, üyelerden birisi Kosova Eğitim ve Bilim bakanı tarafından atanan uluslararası bir uzman olmalıdır. Mu maddeye göre üyeler, uzman olmak zorundadır, bu oluşumda topluluk üyelerine yer verilmemişken, uluslararası düzeyde uzmana yer ayrılmıştır. Bu durumda konsey, ya topluluklardan 2 üye ile genişletilmeli ve konsey üyelerinin sayısı 11’e çıkarılmalıdır ya da bir alt fıkrayla kurumlardan en az iki üyenin, topluluk sıralarından bir uzman olarak atamasını öngörülmelidir.

Yasanın 20. maddesine çok dilli eğitim kurumlarında müdür ve en azından müdür yardımcılarının topluluk sıralarından da seçilmesi, eklenmesi gerekmektedir. Yasanın 24.7 noktasında da topluluklara yönelik spesifik müfredat eğitim plan ve programlarının topluluk dillerinde de hazırlanıp tercüme edilmesi gerekmektedir. Ayrıca dil, tarih, resim sanatı ve müzik dersleri için de özel plan ve programlarının hazırlanması gerekmektedir. Ayrıca Türkçe eğitimde Arnavut dili kitapları için de özel müfredatta yer verilerek özel plan ve programlara göre kitaplar hazırlanmalıdır. Son olarak da yasanın 27. maddesine değinmek istiyorum, topluluklara yönelik ders kitaplarının sağlanmasını düzenlemektedir bu madde, ancak bu maddede Türk, Boşnak ve Rom eğitimini göz önünde bulundurursak, kesinlikle memnun edici değildir, bu yüzden bu maddenin de düzeltilmesi gerekmektedir. Türk dilinde ve Boşnak dilinde ders kitapların ücretsiz dağılımı söz konusu olunca 27. maddenin 2. paragrafında “resmi olmayan diller üzere ders kitapları, ihtiyaca göre ücretsiz sağlanır” ifadesi yer almakta. Oysa aynı maddenin birinci fıkrasında, söz konusu ders kitapları ile ders araç- gereçlerin dağılımı, Sırp dilinde eğitim için “ihtiyaca göre değil” “ücretsiz dağıtılmalıdır” ifadesinde, net bir şekilde belirtilmektedir. Bizler bu maddenin birinci fıkrasının değiştirilmesini, toplulukların dilleri ve diğer diller üzere eğitimin aynı şartlara sahip olmasını sağlayacak olan tutumun bu maddeyle düzenlenmesi gerektiğini düşünüyoruz.

Saygılarımla

KRYESUESI: Faleminderit! Tash përfaqësuesit e grupeve ose grupet përfunduan. Ju njoftoj që për diskutim janë paraqitur Xhevahire Izmaku, Gëzim Kelmendi, Amir Ahmeti, Duda Balje, Emilia Rexhepi, Lumnije Morina, Kimete Bajraktari, Myfera Shiniq, Ganimete Musliu. Thjeshtë, për ta ditur kush janë paraqitur. Xhevahire Izmaku, e para!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Para se të jap mendimin tim si anëtare e këtij komisioni, dëshiroj një sqarim ta jap tek vërejtja tek nen 22 i kolegut tim Kasolli. Mendoj se është mirë e shkruar, pra është vendim i Ministrisë dhe dihen kompetencat, nuk është vendim i ministrit. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj para kolegëve se në Komision kemi qenë shumë më kreativ edhe në opinione, së bashku do me thënë, jo si këtu...

Projektligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës konsideroj se është një projektligj i hartuar gjithëpërfshirës, i avancuar dhe i hartuar sipas standardeve ndërkombëtare të kualifikimit të arsimit të miratuara nga UNESCO në vitin 1997.

Projektligji qartëson në mënyrë të dukshme funksionimin në progres, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, ndahet pra në edukimin para fillor, arsimin fillor, arsimin e mesëm, të ulët, arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin terciar.

Edukimi para fillor apo niveli zero duke përfshirë fëmijët nga mosha pesëvjeçare. Për herë të parë në këtë projektligj bëhet i obligueshëm për gjithë fëmijët e kësaj moshe, çka do të thotë, mendoj se është një përgatitje shumë e mirë paraprakisht e këtyre fëmijëve për arsimin fillor, ndërsa shkollimi i detyruar është falas për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Projektligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës e rrit edhe përgjegjësinë e prindit për vijueshmërinë e fëmijës në shkollë. Po ashtu rritet përgjegjësia edhe e nxënësit dhe mësimitdhënësit, si dhe gjithë e akterëve dhe institucioneve edukativo-arsimore dhe në këtë mënyrë i jepet fund braktisjes së shkollimit të detyruar nëpër shkollat e Kosovës.

Ky ligj i mbron të drejtat për arsimim pa dallim, duke rritur për këtë përgjegjësinë e përbashkët të prindërve, institucioneve arsimore, komunave dhe Qeverisë, duke ofruar shërbime më efektive profesionale dhe gjithëpërfshirëse, me të drejta të barabarta për shkollim, konform normave të miratuara ndërkombëtare për arsim, të drejtat e fëmijëve dhe avancim të barazisë gjinore.

Ligji po ashtu mbron, respekton dhe avancojnë të drejtat e të gjitha komuniteteve që të kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë dhe gjuhën e tyre. Me këtë ligj garantohet arsimimi gjithëpërfshirës i përcaktuar edhe në dispozitat e Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve të vitit 1989 dhe të Deklaratës së Selemankës në vitin 1994 dhe Konventës së OKB-së për persona me aftësi të kufizuara. Ky ligj po ashtu mbron të gjitha grupet e ndjeshme nga çdo formë e abuzimit dhe diskriminimit dhe në këtë mënyrë i jepet fund ndëshkimit fizik të nxënësve.

Me pak korrigjime, që mendoj do të inkorporohen nga kolegët tanë juristë, si për shembull tek neni 17, paragrafi 11.1, ku thuhet “të hartojë rregullat e shkollës” të specifikuara në neni 22 të këtij ligji për t’u miratuar nga komuna. Komenti im është tani që komunat pra i kanë të ndara pushtetet dhe të gjitha aktet nënligjore i miratojnë kuvendet komunale. I njëjti korrigjim duhet të bëhet edhe tek neni 22.1 “Ky ligj do t’i sjell Kosovës një arsimim dhe edukim edhe më cilësor dhe të avancuar, ku Kosova do të ndërtohet në rrugën e të bërit shtet i dijes”. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Izmaaku! Deputeti Gëzim Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe kolegë deputetë të nderuar!

Ne sot para veti kemi shqyrtimin e parë të Projektligjit për arsimin parauniversitar. Pa dyshim se ky projektligj është ndër më të rëndësishmit nga se ka për bazë arsimimin e brezave të ri, konkretisht të ardhmërisë sonë. As mos zhvillimi ekonomik i një vendi nuk do të ketë pasoja më të mëdha negative se sa edukimi dhe arsimimi jo i mirëfilltë i rinisë sonë.

Edhe pse në këtë projektligj nuk i është kushtuar shumë rëndësi komponentës edukative, ndërsa kryesisht asaj arsimore, duhet të jemi shumë koshientë dhe të kujdesshëm se çka po i ofrojmë rinisë sonë, ardhmërisë sonë.

Në Projektligjin që kemi para veti ka shumë mangësi, në të cilat unë nuk do të isha ndalur dhe t'i përsërisë si kolegët parafolës, por do të ndalem vetëm në atë çka është më kryesore.

Neni 3, paragrafi 7, citoj: “Institucionet publike arsimore duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera të cilat propagandojnë një fe të caktuar”. Ky nen shihet qartë se është nen kundër kushtetues dhe në kundërshtim të plotë me Konventën evropiane dhe ndërkombëtare.

Unë e them me bindje dhe përgjegjësi të plotë se vendet e Bashkimit Evropian, ku synojmë edhe ne të jemi pjesë e familjes së tyre, si Austria, Gjermania, Belgjika, Britania e Madhe me pesë vende të rajonit si Kroacia, Sllovenia, Maqedonia, Serbia dhe të tjerët, në shkollat e tyre publike dhe private e kanë edukatën fetare dhe atë si lëndë obligative, ndërsa ne qytetarët e Kosovës nuk e kemi dhe e kundërshtojmë edhe qoftë si lëndë fakultative zgjedhore. Më thoni, ju lutem, a është Kosova më shumë shtet laik se këto vende të Bashkimit Evropian? Të gjithë e dimë se nuk është dhe nuk mund të jetë më shumë laike, por me projektligjin të cilin ne e kemi para veti promovojmë një sistem komunist ateist, ku mësimi fetar ndalohet në shkolla.

Vetëm në periudhën e hershme të komunizmit edukata fetare është ndarë në shkolla dhe sa për informatën e kolegëve, të nderuar deputetë, edukata fetare ka qenë para komunizmit, por me ardhjen e komunizmit është ndaluar nga shkollat, ndërsa të njëjtën ne sot po e bëjmë dhe prapë i përngajmë sistemit komunist dhe e ndalojmë edukatën. Me komunizëm nuk shkohet në Evropën laike. Qëllimin e kemi të mirë, integrimin në Bashkimin Evropian, por mjetin të cilin e kemi zgjedhur e kemi të gabuar.

Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, citoj: “Kosova është shtet laik...” dhe edukata fetare nuk cenon laicitetin e Kushtetutës së Kosovës, ashtu si nuk e ka cenuar edhe laicitetin e kushtetutave laike të Bashkimit Evropian. Përmes edukatës fetare fëmijët tanë do të arrijnë të ngritën më shumë në aspektin intelektual e shpirtëror dhe duke njohur zotin si krijues dhe vetveten si krijesë do të jenë shumë më larg vetive negative të cilat sot e kanë pllakosur vendin tonë. Dhuna në shkolla, narkomania, konsumimi me substanca duhani, narkotiku e alkooli, prostitucioni, mos respekti ndaj mësimdhënësve dhe prindërve, vetëvrasja dhe vëllavrasja, e të gjitha këto, të cilat kanë gjend vend te ne.

Sa për informatë tjetër, dua vetëm edhe t'ju informoj se nga ky nuk janë të ndalur fëmijët e nacionalitetit serb. Ata qysh me vite me radhë e kanë edukatën fetare në shkollat e tyre publike dhe unë këtu shfrytëzoj rastin t'i falënderoj dhe t'i përgëzoj deputetë serbë që kanë menduar shumë herët për brezat e tyre të ardhshëm, ndërsa ne nuk po mendojmë. Ne e kemi lënë një rrugë pa kthim dhe pa udhë. Fundja, çdo fëmijë i Kosovës i cili paguan tatimin, ka të drejtë ta ketë edhe edukimin, njëherësh të mendojmë drejt dhe të gjykojmë drejt pa politizuar dhe pa polarizuar. Fëmijët pa dyshim se do të mësojnë për

fenë e tyre, qoftë në rrugë, qoftë në internet apo diku tjetër, po ne nuk guxojmë t'i lejojmë në një gjë të tillë. Ne duhet që mësimin dhe fenë ta orientojmë në institucione legjitime dhe njerëzit legjitimë. Shumë faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash Amir Ahmeti e ka fjalën!

AMIR AHMETI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Para vetes kemi një Projektligj që është shumë i rëndësishëm për brezat tanë dhe për këtë arsye edhe desha për të dhënë një kontribut dhe disa vërejtje për arsimin parauniversitar në Kosovë.

Ne konsiderojmë se arsimi është bazament i të ardhmes së fëmijëve tanë dhe për këtë arsimin dhe edukimin që kemi gjetur të përmendur në këtë projektligj konsiderojmë se arsimimin pa edukim do ta quaj të mangët, madje arsimin pa edukim do ta quaj si steril, pa vlera, pa moral dhe pa kulturë.

Do të ndalem vetëm te dy nene, te neni 3, paragrafi 7 dhe neni 5 paragrafi 1 dhe 4.

Neni 3, paragrafi 7, thotë: "Institucionet publike, arsimore duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare."

Ne konsiderojmë se kjo është një gabim trashanik të cilin ky ligj e parasheh, sepse ne po synojmë Evropën dhe ky nen është në kundërshtim të plotë me Konventën evropiane të të drejtave të njeriut.

Të kundërtën e nenit 3, ne e shohim pikërisht edukatën fetare, e shohim si një element konstruktiv dhe stabilizues në shkollat tona dhe në shoqërinë tonë, përkundër të drejtës së çdo qytetari evropian që e ka për të mësuar edukatën fetare në shkollat e tyre, edhe ne duhet të plotësojmë këtë të drejtë të evropianëve të ri apo Young European që ne po synojmë.

Ana tjetër e nenit 3, e paragrafit 7, dua të pyes se a vlen vetëm për shqiptarët apo edhe për komunitetin serb. Unë përshëndes këtu angazhimin e tyre për edukatë fetare në shkolla. Këtë e konsideroj diskriminim për shqiptarët, sepse kolegët serbë, deputetë që janë në të njëjtin Parlament ku jemi edhe ne, fëmijët e tyre mësojnë edukatë fetare në shkollat e tyre në Kosovë dhe fëmijët tanë nuk mësojnë. Përkundrazi, tentohet që me ligj të ndalohet kjo gjë dhe kjo është e pa pranueshme për neve dhe nuk guxon të jetë si paragraf i këtij ligji kur vjen në leximin përfundimtar.

Laicizmi, sekularizmi, cili do qoftë mbiemri i Kosovës tonë, ne as nuk e kemi shpikur laicizmin e as sekularizmin. Po ashtu, ne e dimë të gjithë se të gjitha vendet evropiane janë shtete laike apo sekulare, por prapë atje mësohet edukata fetare, madje ajo çka është

më paradoksale, nipërit tanë dhe mbesat tona që jetojnë në vendet evropiane mësojnë edukatën fetare, ndërsa në vendin tonë nuk e mësojnë.

Pika tjetër që dua të ndalem është te tekstet shkollore, ku pika 5.1 shkruan: “Promovon zhvillimin intelektual, moral, kulturor dhe fizik të nxënësve dhe të shoqërisë”. Ne mendojmë se nuk qëndron e tillë, sepse nuk munden të mësojnë moral, kulturë pa një edukatë të mirëfilltë kombëtare dhe fetare, e po ashtu edhe pika 5.4, ku thuhet: “Promovon frymën e respektit, mirëkuptimin, tolerancën në mes të gjitha komuniteteve”. Këtu mungon konfesionit fetar, domethënë që mos të ketë respekt, tolerancë në mes të konfesionëve fetare.

Për të sugjeruar Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë për rikthimin e edukatës fetare në shkollë, konsiderojmë se një përpilim i tillë nuk është, nuk i ngjanë një ligji bashkëkohor dhe demokratik dhe për ilustrim, të nderuar kolegë deputetë, këtu kam një mostër të abetares së vitit 1942, të shkronja Xh, ku shkruan “xhamia” dhe thotë: “një xhep, një xhybe. Sa xhamia ka qyteti ynë”? Domethënë, viti 1942, pa shkel thundrat e komunizmit e bolshevizmit, nuk e kemi pasur këtë problem, po me komunizmin e kemi këtë problem dhe ende po mbetet dhe mendësia komuniste ende është, po qëndron në vendin tonë dhe për këtë arsye lusim Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë që këtë paragraf ta largojë menjëherë, por edhe të shtojë mundësinë sipas ligjeve evropiane, për shembull modelin austriak apo modelin e Belgjikës ta marrim si model për arsimimin e edukatës fetare në shkollat tona publike dhe private. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Argumentet keni të drejtë për t’i bërë, por si prejdukim mos i bëni, si argumente po. Sepse, këto nëse s’bëhen amendamente, krejt këto biseda sot na shkojnë huq. Këtu është problemi. Domethënë, duhet të bëhen amendamente dhe amendamentet s’i bëjnë Ministria, po i bëjmë ne. S’ke çka i lutesh ministrisë. Ajo e ka prur draftin, kjo është punë e Kuvendit tash. E ka fjalën Duda Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsjedavajući!

Vi ste čuli stav moje Parlamentarne grupe, a ja ću sa izlaganjem pokušati da se skoncentrišem samo na pojedine tačke zakona koje se tiču obrazovanja na manjinskim jezicima, konkretno u članu 2. stav 1, tačka 29. Neslužbeni jezik je vrlo konfuzno objašnjen, sam pojam “neslužben” ne deluje ozbiljno a negde se koristi kao “nezvanični” jezik.

U članu 5. Ustava Republike Kosova se kaže – “Turski, romski i bosanski jezik imaju status službenih jezika na opštinskom nivou ili će biti kao službeni na svim nivoima u skladu sa zakonom”.

Ako Ustav Kosova spominje ove jezike kao službene, ovim nacrtom se gazi Ustav jer se tumačenjem dolazi da su navedeni jezici neslužbeni. Ovakva formulacija nije u skladu sa odredbama Zakona o zaštiti i promovisanju prava zajednica i njihovih pripadnika na Kosovu, konkretno sa članom 4. tačka 1. koji ima isti tekst kao i citirani Ustavni član.

Takođe, formulacija iz člana 2. stava 1, tačka 29. nije u skladu ni sa važećim Zakonom o upotrebi jezika na Kosovo, i to sa članom 2. gde se spominju izrazi “službeni jetik”, “zvanični jetik”, “jezik u službenoj upotrebi”. Nigde se ne spominje “neslužbeni jetik”.

Smatramo da je potrebna reformulacija ove tačke i u opšte ovog pojma. Mišljenja smo takođe da je potrebna podela na službene jezike i na jezike u službenoj upotrebi, dakle da se u ovom nacrtu umesto izraza “neslužbeni” koristi reč „jezik u službenoj upotrebi“.

Da podsetim ponovo na Ustav, koji kaže da turski, romski i bosanski jezik imaju status službenih jezika na opštinskom nivou ili će biti službeni na svim nivoima u skladu sa zakonom. Pitanje je u kom će zakonu ovi jezici postati službeni na svim nivoima ako ne u ovom koji se tiče veoma važne stvari, a to je obrazovanje.

Zatim član 27. koji govori o sistemu finansiranja, nije jasan i što se tiče nas proizvoljan je i neodređen. Posebno stav 2. gde se kaže „Udžbenici na nezvaničnim jezicima na nivoima 1. i 2. se prema potrebi obezbeđuju besplatno“. Ovakva odredba deluje kao preporuka, tako da će biti potrebno da se stalno dokazuje stina, odnosno fakti od strane manjinskih zajednica o potrebama o udžbenicima i njihovom besplatnom štampanju praktično svake godine.

Zahtevamo da se iz zakona, odnosno prethodne citirane rečenice izbriše reč „prema potrebi“ a uzimajući takođe u obzir i prethodni paragraf u datom zakonu 27.1, koji se odnosi na obrazovanje, odnosno udžbenike na srpskom jetiku, gde se tačno govori da će udžbenici i druga potrebna sredstva na srpskom jeziku biti štampana besplatno.

Imamo takođe i nekih primedbi vezanih za kurikulum, a o tome ćemo u Komisiji, koja je zadužena za obrazovanje, dati svoje posebne stavove. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Emiliya Rexhepi e merr fjalën!

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovani ministri,

Kolege poslanici,

Iskoristiću priliku da vas zamolim da ozbiljno shvatimo Nacrt zakona o preduniverzitetskom obrazovanju na jezike manjinskih zajednica, posebno u opštinama gde je zakonski regulisana službena upotreba manjinskih jezika, kao što je statut opštine i razna administrativna uputstva koja govore o pravu manjinskih zajednica na slobodu govora i upotrebe svojih jezika u obrazovnom sistemu.

Posebna primedba ide Komisiji za obrazovanje, odnosno članovima Komisije koji dolaze iz manjinskih zajednica da izmene odnosno okvir kosovskog kurikuluma, posebno kada se govori o članu 27. tački 2. gde decidno stoji da udžbenici na nezvaničnim jezicima na nivou 1. i 2. se prema potrebi obezbeđuju besplatno, odnosno tu ne bi stajala prema potrebi reč, odnosno trebalo bi stajati da je to obavezno.

Takođe, imamo primedbu i na tački 1,3. gde je dodatno finansiranje iz opšteg granta opštine zavisno od finansijskih mogućnosti opštine, ne bi trebalo tu stajati „zavisno“ nego bi trebalo stajati „obavezno“.

Ono što je takođe jako bitno za manjinske zajednice, jeste takođe kurikulum, odnosno okvirni stav kurikuluma, tačka 2. u članu 35. oko imenovanja direktora i zamenika direktora po opštinama, odnosno tamo gde su manjinske zajednice dominantne. Konkretno, na primer, govoriću o opštini Prizren, gde najveći postotak manjinskih zajednica nema nijednog direktora niti u osnovnim niti u srednjim školama, a o zamenicima direktora u opšte i da ne govorimo.

Takođe, član 24. tačka 7. jako je važan za pripadnike manjinskih zajednica, a on govori o nacionalnoj grupi predmeta, odnosno o istoriji, o likovnoj i muzičkoj umetnosti, gde bi tražili od Vlade, odnosno posebno od Ministarstva za obrazovanje specifičan prevod za određenu grupu predmeta. Zahvaljujem! Mi u suštini podržavamo ovaj nacrt zakona uz adekvatne izmene u Komisiji za obrazovanje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr Lumnije Morina!

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Projektligji për arsimimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, që sot po e shqyrtojmë, ka për qëllim që të rregullojë edukimin, arsimimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve në nivelet përkatëse.

Në këtë projektligj do të vendosen parimet e përgjithshme të arsimimit parauniversitar duke i marrë parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimim të këtij niveli.

Gjithashtu, rregullohet mbikëqyrja, administrimi dhe menaxhimi i institucioneve arsimore, si dhe sigurohen politikat gjithëpërfshirëse, si për shembull për integrimin e personave me vështirësi në të mësuar dhe me aftësi të kufizuara, si dhe arsimimin dhe aftësim e të rriturve. Derisa në kuadër të Projektligjit Ministria obligohet të nxjerrë edhe akte tjera nënligjore lidhur me rregullimin e kalendarit shkollor, të kohëzgjatjes së orëve mësimore, pushimeve shkollore, numrit të nxënësve e tjerë, mendoj që ka qenë mirë që edhe me një akt nënligjor të obligohet Ministria e Arsimit që të rregullojë përcaktimin e procedurave disiplinore për nxënësit në rastet kur bëhet shkelja e rregullave dhe rendit nëpër shkolla, sepse personeli arsimor dhe udhëheqja e shkollave vazhdon të ballafaqohet me probleme nga më të ndryshme të cilat i shkaktojnë nxënësit gjatë procesit mësimor dhe në mungesë të kompetencave nxënësit nuk e marrin ndëshkimin e merituar.

Propozoj që kompetencat për udhëheqjen dhe zbatimin e masave disiplinore të barten tek organet e shkollave e jo këto kompetenca t'i kenë organet e komunave për marrjen e vendimeve në rastet kur bëhet suspendimi i nxënësve për një muaj apo edhe për raste tjera.

Gjithashtu, mendoj që me këtë projektligj, me një akt gjithashtu nënligjor duhet të parashihet dhe të rregullohet problemi i mësimdhënësve me përgatitje të lartë shkollore, pra me shkolla të larta e që këta mësimdhënës kanë nga 10, 15, 20 e më shumë vite përvojë pune si mësimdhënës.

Problemi është që në çdo fillim të vitit shkollor atyre iu rrezikohet vendi i punës dhe derisa vazhdon programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rikualifikimin e kësaj kategorie të mësimdhënësve, propozoj që me një akt nënligjor të rregullohet pozita e kësaj kategorie të mësimdhënësve që të mos iu shpallet vendi i punës në çdo fillim të vitit shkollor deri sa të përfundojë projekti i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rikualifikimin e të gjithë mësimdhënësve pa shprehje nga puna në nivelin parauniversitar të Kosovës. Ju falënderoj për vëmendjen tuaj!

KRYESUESI: Edhe ty të falënderojmë për kontributin! Deputetja Kymete Bajraktari!

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë!

Projektligji për arsimin parauniversitar parasheh rregullimin e shumë çështjeve të arsimit publik dhe privat parauniversitar në Republikën e Kosovës në nivelin kombëtar të ..., pasi që me ligj të veçantë është e rregulluar kjo sferë, siç janë Ligji mbi arsimin parashkollor, Ligji mbi arsimin profesional, Ligji mbi arsimin e komunave të Kosovës e të tjera.

Projektligji për arsimin parauniversitar pretendon të parasheh rregullimin normativ të kësaj fushe sipas standardeve të parapara me konventa ndërkombëtare sa i përket të drejtës së arsimimit me një përfshirje sa më të plotë të fëmijëve dhe të rriturve dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Kjo sferë e rëndësishme e shoqërisë është një bazë e mirë për një shoqëri të ardhshme prosperuese. Projektligji si i tillë parasheh kompetencat, të drejtat dhe detyrimet, përgjegjësitë, aspektet financiare e tjera sa i përket nivelit komunal dhe qendror.

Projektligji ka paraparë gjithashtu formimin e Këshillit shtetëror për arsimin parauniversitar, Këshillit të prindërve të Kosovës, Këshillin drejtues në institucionet aftësuese dhe arsimore, Këshillin e nxënësve e tjera, duke paraparë mënyrën e formimit të tyre, përbërjen e tyre dhe përgjegjësitë.

Edhe pse ky ligj rregullon fushën e arsimit, ka hapësirë për plotësime dhe sqarime në implementimin e tij.

Në disa nene Ministria obligohet në krijimin e akteve nënligjore për çështje të cilat është dashur që të jenë në ligj, domethënë nuk ka përshkrim preciz të përgjegjësiave dhe kompetencave.

Neni 1, paragrafi 1.31, thuhet: “Shërbim pedagogjik në shkollë është shërbimi arsimor dhe aftësues që ofrohet nga këshilltari, pedagogu, psikologu, bibliotekari, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të punës në shkollë”. Cili është roli i këshilltarit në shkollë?

Te neni 1, paragrafi 1.37 është përcaktuar periudha kohore për vitin shkollor që fillon në shtator dhe përfundon më 31 gusht, ndërsa nuk është përcaktuar periudha kohore e vitit mësimor.

Neni 5, paragrafi 1.4, te detyrat e ministrisë. Në këtë nen ceket avancimi i masave për parandalimin e braktisjes së nxënësve nga shkollat. Këtu nuk është bërë caktimi i masave. Ne e dimë që braktisja e nxënësve nga shkollat është një shqetësim i cili duhet të na preokupojë të gjithëve, e sidomos kur në shumë komuna është duke ndodhur me të madhe. Ndër to është edhe komuna e Prizrenit, që në vitin shkollor 2010 – 2011 shkollimin e kanë braktisur përafërsisht 2.000 nxënës, përfshirë këtu edhe komunitetet pakicë.

Në ligj mungon hartimi i të drejtave, detyrimeve dhe lirive themelore të nxënësve. Rritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie është prioritet për ministrinë. Shpresojmë se me akte nën ligjore Ministria do të parashihet forma për stimulimin, për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Duke e ditur se 60% e nxënësve vijojnë mësimet në shkollat profesionale, Ministria është dashur të parashohet me ligj përgatitjen e nxënësve për tregun e punës.

Një çështje mjaft brengosëse sot në Kosovë është dukuria e mos vijimit të shkollimit të obliguar nga nxënësit ose fëmijët e prindërve që nuk ushtrojnë kujdesin e obliguar me ligj për arsimimin e tyre, kur për arsye të neglizhencës nuk kujdesen për ta.

Edhe pse ky projektligj e parashihet këtë dukuri në nenin 15 paragrafi 4, me dispozitë ndëshkuese për prindërit me gjobë apo dënim, propozuesi i këtij projektligji nuk ka paraparë në mënyrë të detajuar veprimet e institucioneve gjegjësisht të personave kompetentë për ndërmarrjen e masave për eliminimin e kësaj dukurie, me qëllim që arsimi parauniversitar, fillor është i obliguar e jo që kjo dukuri të jetë vullneti i prindërve që për shkak të neglizhencës apo të ndonjë qëllimi tjetër janë të pa përgjegjshëm për sjelljet e tyre në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre.

Nga ky aspekt, ky projektligj duhet të parashihet në mënyrë shprehimore se kush është kompetent të ndërmarrë veprimin fillestar për ndërmarrjen e masave ndaj prindërve për mos vijueshmëri, braktisje, mos regjistrim, kush e udhëheq procedurën për gjobitjen, gjegjësisht dënimin në gjykatën kompetente. E një gjë të tillë ligji vetëm në mënyrë provizore e përmend se komuna e njofton Ministrinë për dukurinë e mos vijueshmërisë, braktisjes, mos regjistrimit, pa përcaktuar akterët në këtë drejtim.

Si po duket, një dukuri e tillë nuk i brengos shumë propozuesit e këtij projektligji dhe nuk dëshirojnë që këtë dukuri ta marrin me shqetësim, pasi që nuk janë të interesuar ta rregullojnë me ligj.

Flitet se Kosova po plotëson standardet e duhura evropiane për arsimimin e fëmijëve, por si po shihet, në realitet, ne po stimulojmë dukurinë e analfabetizmit. Ky është një shqetësim serioz që po e kërcënon shoqërinë tonë sot.

Pastaj, me normativë të definohen kualifikimet adekuate të mësimdhënësve sipas niveleve të shkollimit.

Në ligj nuk janë paraparë procedurat për pensionimin e mësimdhënësve. Ky ligj i vonuar si duket do të vonohet edhe më shumë, deri në zbatimin e tij për arsye se MEF-i paraqet implikime buxhetore dhe implementimi i tij i tërësishëm parashihet tek në vitin 2015 – 2016.

Përpilimi i ligjeve të mangëta, për shkak të implikimeve buxhetore nuk arsyeton Qeverinë për mos hartim të ligjeve si duhet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputetja Mufera Shinik.

MUFERA ŞINIK: Kosova Cumhuriyeti Üniversitesi Eğitim Yasa Tasarısı

Bilindiği üzere bir toplumun, bir ülkenin gelişmesi, ilerlemesi ve diğer ülkelerle ve topluluklarla entegre olması için eğitim en önemli bir konudur.

Bu yüzden bugün görüşülen Kosova Cumhuriyeti Üniversitesi Eğitim Yasa Tasarısı’nı çok iyi bir şekilde inceledik.

- Başta Müfredatın hazırlanmasında bugüne kadar var olan özgün derslerde mesela Anadili, Tarih, Müzik ve Resim dersleri için şekli değişirmeden aynı şekilde kalarak, toplulukların ana ülkelerinden uzmanların getirilebilmesi açık bir şekilde Yasanın 24. maddesinde ifade edilmeli ve Müfredattan ders plan ve programların topluluk dillerine tercüme edilmesi gerekir.
- Kitap konusuna gelince, bu Y/T’nin 3. ve 27. maddeleri birbirine ters düşmektedir, buna özellikle dikkat edilmesi gerekir ve ders kitaplarının ücretsiz dağıtılması sağlanmalı.
- Ders araç-gereçleriyle birlikte yardımcı ders kitaplarının da topluluk dillerinde kitapla uyumlu bir şekilde basılmalıdır.
- Y/T’nin 20. maddesine göre müdür ve müdür yardımcılarının seçilmesinde, topluluk öğrencilerinin olduğu okullarda müdür ve yardımcısının topluluk sıralarından seçilmesi ve aynı zamanda Diller Yasasına göre, herhangi bir topluluk mensubu olan müdür ve yardımcısının, en azından o belediyenin resmi dillerini bilmesi gerekliliği şartı koyulmalıdır.

Aynı zamanda 21. maddede Sekreterin seçilmesinde de dillerin bilinmesine dikkat edilmesi gerekir.

1. Këto propozime iu janë dorëzuar edhe Ministrisë së Arsimit ose thënë shkurtimisht - Grupit punues për amendamentimin e këtij ligji.

Njëkohësisht kërkoj që këshillat e nxënësve të mos mbesin më vetëm në nivelin e shkollave, mirëpo të ngrihen në nivelin nacional. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë të nderuar dhe të respektuar, unë meqë jam vetëm këtu, më lejoni, ndiej nevojë t'i them disa fjalë për këtë ligj, pa zbritur tutje.

Konsideroj që ky ligj për arsimin parauniversitar, bashkë me Ligjin për arsimin universitar, që e kemi në Kuvend dhe do të vijë në shqyrtim, sigurisht pas një jave, përbëjnë dy ligjet më të rëndësishme për një sistem shumë të ndërligjshëm, siç është sistemi i arsimit në të gjitha nivelet në Kosovë. Një, për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme që kanë ligjet që kodifikojnë këtë pjesë të jetës sonë, që është themeloria dhe e cila prodhon, jep dhe merr dijen dhe do ta bëjë funksionale për këtë pjesë. Dhe, e dyta, sepse implikon direkt në arsim 1/4 e popullsisë dhe indirekt gjithë popullsinë e Kosovës. Pra, interesi është totalisht i të gjitha shtresave të popullsisë së Kosovës.

Mund t'ju them që ky ligj është një ligj i parë, i cili në një variant ka kaluar në legjislaturën e parë të Parlamentit të Kosovës. Ka pasur edhe një riamendamentim. Ky është pak a shumë varianti i tretë, po them, po e quaj varianti i tretë, sepse në ligjet sistimore nuk bëhet revolucion i jashtëzakonshëm, do të thotë provohet ajo që ka mundur të zbatohet dhe sheshohen dobësitë dhe korrigjohen. Ky është pra një variant i përpunuar i dy varianteve të Ligjit për arsimin parauniversitar, që ka funksionuar në Kosovë në decenien e fundit.

Çfarë ka ndryshime këtu? Ndryshimet më të mëdha që propozohen në këtë ligj janë ato që kushtëzohen dhe i keni të numëruara në Ligjin e famshëm dispozitat kalimtare, neni 49. Lexoni nenin 49, unë besoj që Vataj më duket e përmendi që ata që e kanë lexuar më strikt ligjin, e dinë çka është, që nuk i lexojnë pjesët instruktuese të fillimit, që s'thonë gjë, ato janë deklarata, duhet të shihet esenca në strukturë.

Ky nen 49, ka të bëjë edhe me Ligjin edhe me punën e Kuvendit, sepse neni 49 thotë: "Ministria nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe për çështjet që duhet mbuluar me këtë".

Le të më lejohet një koment i vogël. Pikërisht Ministria është e vetëdijshme që ky ligj, si është hartuar, do shumë akte nënligjore dhe ligjet në veprimtari të gjerë i donë këto, por duhet të insistohet që ligji të ketë sa më pak akte nënligjore, se është më lehtë i zbatueshëm. Të jetë indikativ ligji, në dëftore të shkruhet, jo në dëshirore. Atëherë ka më pak akte nënligjore dhe sa më pak akte nën ligjore, çdo ligj, cilido qoftë, është më i zbatueshëm.

Si do që të jetë, pika 2 e pikërisht këtij neni tash fillon me dispozitat e neneve ose të paragrafëve, të cilat nuk mund të hyjnë në fuqi nga viti, përpara vitit shkollor 2015-2016

po qe se krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi ekzakt të kostos financiare të periudhës vijuese. Saktësisht këtë e thotë edhe rekomandimi i atyre që e kanë analizuar buxhetin dhe këta e konsiderojnë që ky është neni fundamental, i cili është virtual në situatën qysh është paraqitur, sepse s'ka shans të mbulohet me para para këtij viti.

Këtu i është dhënë edhe një variant, thotë, qysh vendos Kuvendi. Nuk është puna qysh vendos Kuvendi, se në një pikë të Ligjit Kuvendi s'mund të vendosë asgjë, në rast se ajo është jo e definueshme, domethënë është variabile, kështu që kam parasysh kur po i bisedoj të gjitha këto probleme për mënyrën e amendamentimit, sepse ne sot në parim absolutisht do ta pranojmë ligjin dhe unë them që duhet patjetër të votohet, po ajo që na pret, e pret më së pari komisionin funksional, se ka punë këtu për saktësi. Ka punë për saktësi në shumë pika dhe unë, për të mos marrë kohë, po i përmendi dy, të nenit fundamental që u diskutua ky për laicitetin e shkollës publike, unë besoj se këtu s'kemi çka të bisedojmë, se ky është fundament kushtetues dhe variacionet e të menduarit janë variacione, por flitet për shkolla publike, që as ky ligj dhe asnjë ligj që s'është në frymën kushtetuese, s'ka shans të votohet ose të mos votohet, kështu që s'kemi pse të mbajmë mësim të interesave të grupeve.

Me rëndësi është neni 9.2, faqe 34, ku nuk është definuar saktë. Ka dy, çka është shkollim i detyruar. Kjo duhet të definohet, domethënë, deri ku mbërrin ai.

Dhe neni 26.3, problemi i teksteve shkollore. Ka instrumentariume që tregojnë që tekstet të përdoren vetëm në tekstet që i pranon Ministria me institucionet e vetë vlerësimi, por aty thuhet – tekstet dhe që i zgjedh shkolla. Nuk është precizuar, çka donë të thonë këta, a pranohet në Kosovë alter-teksti apo jo. Duhet të definohet. Nëse pranohet, nëse i lihet dikujt mundësi për të zgjedhur, ai zgjedh kur ka më shumë se një, se nëse ia ofron një bukë, nuk mund t'i thuash - zgjidh cilin lloj po e do? Ky është një soj. Nëse s'ke alter-tekst, s'ka çka të zgjedhë shkolla, por e zgjedh atë libër njëshin që e ka.

Unë kam një vërejtje për hartuesin, pikërisht në pikën 2 të nenit 49, se në evidentimet që i bën çka nuk mund të zbatohet edhe në qoftë se miratohet në Kuvend deri në vitin 2015 – 2016, për pakujdesi ose për mos analizë të atyre që e kanë bërë variantin përfundimtar, hyn edhe neni 28, që ka të bëjë me sistemin elementar të financimit dhe ky është super i definuar, s'ka pse të mbetet pikëpyetje.

Neni 29 i tëri, që flet për delegimin e autoritetit financiar dhe ky s'ka çka e pret 2015-shin, sepse është i definuar.

Neni 35, i tëri, prej faqes 76-79, që ka të bëjë me zgjedhjet e drejtorëve, të mësimdhënësve e tjerë, ato s'kanë shans të presin 2015-shin, sepse drejtorët zgjidhen përditë, edhe mësimdhënës çdo vit shkollor zgjidhen, kështu që unë mendoj që s'ka se si të kushtëzohet modaliteti me këtë vit.

Janë edhe disa të tjera. Unë po abstenoj t'i përmend të gjitha, po po them, le të kihet kujdes, sepse ky nen është shumë fundamental. Meqë iu referohet pikave themelore të zbatimit, atëherë mos të futë brenda edhe ngarkesa që s'kanë të bëjnë hiq me të. Këto

çështje sigurisht do t'i marrë në shqyrtim komisioni funksional i cili ka punë, sepse ligji është i madh, ligji është i rëndësishëm, ligji është i nderligjshëm.

Unë mendoj që duhet ta votojmë dhe ju thërras juve dhe regjinë ta votojmë dhe votojmë tash:

76 deputetë janë prezentë.

Kemi 1 pa kartelë dhe 68 – 69 votojnë “për”, 4 janë “kundër”, dhe 2 abstenojnë.

Në parim, u miratua Projektligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Tash, unë ju këshilloj juve, gati është koha e drekës. Ne kemi pikën e fundit të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.**

A doni të vazhdojmë dhe edhe këtë pikë ta kryejmë? Faleminderit!

Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka propozuar miratimin e këtij raporti me rekomandimet e paraqitura.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratimin.

Radha e diskutuesve është, zëvendëskryetari i komisionit funksional, deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sipas Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës deklaratat financiare të certifikuara nga auditorët e jashtëm dhe një raport mbi veprimtarinë e saj gjatë vitit.

Auditimi i pasqyrave financiare të ZAP bëhet nga auditorë të jashtëm, të cilët zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit dhe në bashkërendim me administratën e Kuvendit, Divizionin e Prokurimit, ka bërë përzgjedhjen e kompanisë BDO Kosova për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it, për vitin 2010.

Raporti mbi veprimtarinë e ZAP-it gjatë vitit 2010 është proceduar për shqyrtim në Kuvend sipas ligjit, por shqyrtimi i tij nga komisioni është shtyrë deri sa është proceduar edhe raporti i auditimit – pasqyra financiare e vitit 2010. Në mbledhjen e mbajtur me datë 29 qershor 2011, Komisioni ka shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Pasqyrat financiare për vitin 2009 dhe 2008 kanë qenë vetëm për njoftim dhe jo për shqyrtim nga komisioni.

Komisioni vlerëson se Raporti vjetor i performancës për vitin 2010 i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është prezantim i mirë i një pune të mirë që ka realizuar Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në këtë sezon, prandaj komisioni ka rekomanduar miratimin e këtij raporti.

Megjithatë, komisioni ka ngritur shqetësimin se një numër i auditimit të performancës është i vogël dhe bazuar në këtë ka rekomanduar që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të shikojë mundësitë për shtimin e auditimit të performancës.

Meqenëse auditimet e performancës janë ato që flasin për tri “e”-të: ekonomike, efikase dhe efektshmëri, si institucion që kontrollohet, i përdorë dhe i menaxhon mjetet financiare. Po ashtu, me qëllim të fuqizimit të pavarësisë financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, komisioni ka rekomanduar si në pikën 3 të rekomandimit.

Po ashtu, edhe në emrin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, rekomandoj miratimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Lladrovci! Për Komisionin për Buxhet dhe Financa, fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 6.2 të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, kjo zyrë është e obliguar që 4 muaj pas përfundimit të çdo viti, t’i dorëzojë Kuvendit të Kosovës një raport për punën e tij gjatë vitit, të cilit raport duhet t’i bashkëngjitet edhe raporti financiar.

Zyra e Auditorit Gjeneral e ka dorëzuar raportin financiar në kuadër të raportit të performancës dhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar këtë raport financiar dhe ka analizuar rrjedhën e shpenzimeve të këtij institucioni.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2010 ka pasur në shfrytëzim 1.571.000, nga këto mjete i ka shpenzuar 1.547.000 apo 98.5% të mjeteve të cilat i ka pasur në dispozicion.

Buxheti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është dyfishuar në vitin 2010, në krahasim me vitin 2008, kurse numri i punëtorëve në këtë zyrë është rritur nga 80 punëtorë, në 116 punëtorë, në vitin 2010, në krahasim me vitin 2008, gjë që vërehet edhe nga krahasimet që janë dhënë në këtë raport financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në vazhdimësi është angazhuar për të plotësuar kërkesat financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në mënyrë që ky institucion i rëndësishëm të ruajë pavarësinë e vet financiare duke e ditur se ka një rol shumë të rëndësishëm në rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit, respektivisht të menaxhimit të financave publike.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, pas marrjes së përgjigjeve nga Auditori i Përgjithshëm për rrjedhën e shpenzimeve në disa kategori, në mbledhjen e mbajtur më 11.5 të vitit 2011, ka vlerësuar se ky raport i përmbush obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Hadërgjonaj, faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra të pranishëm,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2010 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Nga pasqyrat e paraqitura tregon se ka një progres të vazhdueshëm prej viti në viti, por edhe sikurse në organizatat tjera buxhetore, nuk mund të tejkalohen problemet, siç janë rregullsia në burime njerëzore, dokumentacioni, paraqitja e aseteve fikse dhe stoqet. Edhe kjo e ka përcjell edhe Zyrën e Auditorit, e cila për ne ka qenë pak a shumë e paqartë, sepse është organi më i pavarur, i cili thirret apo i ka në detyrë auditimet, si të rregullsisë, ashtu edhe të preformancës.

Janë disa vërejtje apo sugjerime parimore, të cilat Grupi Parlamentar i LDK-së më shumë i merr si shqetësuese. E para, ka të bëjë me interferimet politike në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në përgatitjen e raporteve, sidomos për ministritë, por edhe për organizatat tjera buxhetore të cilat menaxhojnë me mjetet e taksapaguesve të Kosovës.

Edhe pse nga auditori nuk është thënë asnjë fjalë se ka ndërhyrje në pavarësinë e auditorit, në anën tjetër kërkohet pavarësia të jetë buxhetore, e cila lidhet direkt me ndikimin politik.

Ne mendojmë se duhet të përkrahen edhe disa rekomandime që i ka dhënë Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, sepse auditorit si kategori kushtetuese duhet t'i sigurohet pavarësia dhe mos të ketë qasje apo ndikime politike në hartimin e raporteve.

Sa i përket, edhe një herë, paraqitjes së pasqyrave financiare dhe auditimin e bërë nga auditori i jashtëm BDO, ne mendojmë se janë në rregull dhe mendoj se si raport i japim përkrahjen, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Visar Ymeri, flet për Grupin e "Vetëvendosjes"!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Edhe ne në parim e mbështesim Raportin e auditimit të Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrat financiare që i ka dorëzuar ky në Kuvend.

Kisha dashur vetëm shkurtimisht t'i ngrejë disa shqetësime që kanë të bëjnë edhe me raportin, por edhe me punën në përgjithësi të kësaj agjencie.

Po ashtu, edhe ne pajtohemi që kjo është një prej institucioneve shumë të rëndësishme për sa i përket shëndetit, të them ashtu, financiar të shpenzimeve të parasë publike në Kosovë, në përgjithësi, nga agjencitë shtetërore, por edhe nga vetë ministritë dhe konsideroj që raportet të cilat bëhen nga ky auditor i përgjithshëm, po qe se vërtet të gjithë pajtohemi se janë raporte në të cilat duhet besuar, atëherë edhe Qeveria, po edhe kuvende të ndryshme komunale duhet të veprojnë sipas atyre raporteve dhe t'i marrin ato pak më seriozisht e jo t'i përdorin ato vetëm kur janë pozitive, po veçanërisht kur aty vërehen shumë parregullsi, siç po shohim që auditori ka vërejtur edhe në pasqyrat e disa ministrive gjatë vitit 2010.

Pra, këtu po ashtu është përmendur në faqen 11, që janë diku katër opinione të kualifikuara, edhe pse nuk përmenden se cilat, dhe dy opinione të kundërta, por po ashtu është shqetësuese që njëra prej komunave, nuk përmendet cila, po thuhet që njëra prej komunave ka refuzuar që t'i dorëzojë, domethënë, pasqyrat financiare. Konsideroj që nuk duhet këtë të drejtë ta gëzojë asnjë komunë dhe nuk duhet ta ketë këtë privilegj asnjë agjenci shtetërore, pra janë të obliguara që t'i paraqesin këto pasqyra financiare për shkak se kemi të bëjmë me paratë e qytetarëve të Kosovës dhe jo me paratë personale të askujt.

Për sa i përket raportit financiar të auditorit, mendoj që në këtë raport financiar, meqenëse është auditori i përgjithshëm, pra, të cilit Kosova në njëfarë mënyre ia beson t'i auditojë të gjitha pasqyrat financiare, ishte dashur që pasqyrat e veta financiare t'i ketë pak më profesionale e veçanërisht te kjo letra e auditorit që e ka bërë auditimin e këtyre ..., ku në faqen 34, në fund të raportit ajo vetëm përmendet se pasqyrat financiare janë audituar nga Grand ... dhe opinioni ka qenë i pa kualifikuar, por jo edhe letra complete, siç duhet të vinte nga një kompani audituese, ku do të përmendeshin të gjitha, edhe vërejtje nëse ka pasur vërejtje në pasqyrat financiare.

Edhe një gjë tjetër shtesë, për fund, është e domosdoshme që auditori pra të pavarësohet politikisht dhe financiarisht dhe këtë pavarësim politik ne konsiderojmë që nuk duhet ta kërkojmë vetëm nga institucionet e Kosovës, por edhe nga institucionet ndërkombëtare, po ne e dimë që auditori i përgjithshëm vazhdon të jetë i paguar me një staf tjetër nga Zyra Civile Ndërkombëtare dhe konsiderojmë që kjo është mundësi për ndërhyrje politike në këtë auditor, prandaj kërkojmë që edhe në këtë aspekt të pavarësohet plotësisht auditori. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Për “6+” po më duket Albert Kinolli! Urdhëroni! Atëherë, për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, flet Bali Muharremaj! Albert, pas këtij flet ti!

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të preformancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë, por kryen edhe auditime të performancës dhe të menaxhimit dhe kryerja e auditimit në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit normalisht se mbetet sfida e vazhdueshme për t’u kryer çdo vit.

Për kryerjen e auditimeve të performancës edhe menaxhimit kërkohet kohë, por pasi që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet të forcojë aftësitë e auditorëve për të kryer këto auditime. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është duke u munduar që t’i forcojë këto në mënyrë të vazhdueshme.

Shqetësuese është mos zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, po ashtu edhe fuqizimi i pavarësisë financiare të Zyrës mbetet sfida.

Grupi Parlamentar i Aleancës vlerëson se Raporti vjetor i preformancës me pasqyrat e auditimeve financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 prezantojnë një punë të mirë që ka realizuar Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në vitin 2010 dhe të njëjtën e përkrah bashkë me rekomandimet e komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Muharremaj! Albert Kinolli e ka fjalën!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 dhe mendojmë se ka përparim të dukshëm në këtë drejtim dhe si të tillë e mbështet këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Mos mendoni çka keni në mendje ju, ata që nuk paraqiten, nuk e prekin shenjën për t’u regjistruar, nuk ju kam faj! Nëse nuk

paraqiten, nuk mendoj unë, mendoj që kanë abstenuar. Këtë merreni me mend dhe mësohuni. Tash, Myzejene Selmani, unë besoj për krejt grupin!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!
Përshëndetje, për ministrat dhe deputetët në seancë!

Grupi parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re ka shqyrtuar Raportin vjetor me pasqyrat e auditimit financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 dhe duke marrë parasysh se i gjithë raporti paraqet një gjendje faktike e cila ka ndodh në terren, Grupi i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah raportin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe prej teje! Janë edhe dy diskutues. Valbona Dibra e do fjalën!

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Raporti vjetor i performancës për vitin 2010 i Zyrës së Auditorit Gjeneral vlerësoi se është raport i përgatitur shumë mirë dhe shumë përmbajtjesor.

Raporti tregon të arriturat, konkretisht punën voluminoze për përgatitjen, për përfundimin e auditimeve kryesisht të rregullsisë, krahasuar me dy vitet e kaluara.

Periudha e auditimit 2009-2010 është treguar e suksesshme për faktin se Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer rreth 70 auditime, prej tyre 63 auditime të rregullsisë në kuadër të buxhetit të Kosovës, 2 auditime të rregullsisë të ndërmarrjeve publike, 2 auditime të menaxhimit financiar dhe 1 auditim të performancës.

Me gjithë punën e mirë që është bërë, konsideroj se numri i auditimeve të performancës është ende i ulët. Unë si anëtare e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike kam kërkuar nga Auditori Gjeneral që numri i auditimeve të performancës të rritet dhe nga takimet e vazhdueshme që kemi pasur në kuadër të komisionit, kemi marrë premtime se numri i auditimeve të performancës do të ngrihet në vitet në vijim.

Nga tërë këto raporte të audituara, janë dhënë kryesisht opinione të pakualifikuara, që do të thotë se pasqyrat financiare të entiteteve të audituara në të gjitha aspektet materiale paraqesin gjendje të drejtë dhe reale.

Nga raporti vërehet se numri i opinioneve të kualifikuar është në zbritje dhe kjo është një shenjë e mirë sepse gradualisht po përmirësohet menaxhimi financiar në sektorin publik.

Po ashtu, Zyra ka pasur një realizim të mirë të buxhetit, ku rreth 99% e buxhetit të vitit 2010 është realizuar. Kjo reflekton një përmirësim të madh të aftësisë së Zyrës së Auditorit për menaxhimin e buxhetit.

Dhe, në fund, dua të theksoj se Zyra e Auditorit Gjeneral ka marrë opinion të pa kualifikuar me rastin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010. Faleminderit!

KRYESUESI: Diskutuesi i fundit është zoti deputet, Sali Morina!

SALI MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë gjithashtu e mbështes miratimin e këtij raporti. Raporti vjetor i performancës tregon një progres të mirë për vitin 2010, tregon një forcim të vazhdueshëm të auditorit të përgjithshëm, funksionin e rëndësishëm për ndërtimin e një qeverisjeje të mirë, besimin në mënyrën e shpenzimit të fondeve publike dhe gjithashtu t'i mbajnë menaxherët në llogaridhënie.

Për ne, si Kuvend i Kosovës, janë tri gjëra esenciale në lidhje me funksionet e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës...

Nën një, që pavarësia dhe funksionet e Auditorit të Përgjithshëm janë të siguruara me ligj. Ky është një parakusht që funksionet të jenë të mjaftueshme për të bërë auditimin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit. Situata e tanishme nuk është edhe aq e kënaqshme. Në praktikë Auditori i Përgjithshëm ballafaqohet me sfida financiare dhe vendime bazuar në zbatimin e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, si dhe në Ligjin mbi shërbyesit civil.

Andaj, kërkoj që Ligji mbi Auditorin e Përgjithshëm duhet të vendoset në agjendën e Kuvendit deri në vjeshtën e këtij viti. Gjithashtu, Kosova ka marrëveshje me Komisionin Evropian që nga viti 2008. Ne këtë marrëveshje thuhet që burimet njerëzore të auditimit duhet të ndërtohen, do të thotë, të rriten për 20% për çdo vit, për një periudhë pesëvjeçare. Në fakt, Kosova ende nuk e ka përmbushur këtë marrëveshje plotësisht. Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i jepen burimet e mjaftueshme në pajtueshmëri me kërkesat e tyre buxhetore në buxhetin e ardhshëm, si dhe duke marrë për bazë rëndësinë e kësaj zyre, ne duhet ta ftojmë Auditorin e Përgjithshëm të flasë para Kuvendit të Kosovës, kur Raporti vjetor i performancës dhe Raporti i auditimit vjetor të jenë në agjendën e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë deputetë, nuk ka të tjerë që donë të marrin fjalën. Unë ju thërras ju dhe teknikën, të bëhen gati për të votuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Këtu i kemi të pranishëm... Ju lutem, ma jepni numrin e saktë ta prezantoj. Të pranishëm deputetë në sallë janë 75, votojmë tash:

Me 69 vota me elektronikë dhe 1 pa elektronikë – 70 vota janë “për”, 3 janë abstenim dhe 1 është “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Kolegë të nderuar, kjo seancë mbaroi. Shihemi në të tjerat!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve dhe e Lekturës e Kuvendit të Kosovës